

CALL YOUR COUNTRY
FOL ME VENDIN TËND
DUKE FILLUAR NGA 10 CENT/MIN.
WIND
Informacione në wind.it



E PËRMUAJSHME/MENSILE VITI/ANNO VI NR.9 - OTTOBRE/TETOR 2009 - € 1,50

shqiptari i italisë

l'albanese d'italia

CALL YOUR COUNTRY
FOL ME VENDIN TËND
DUKE FILLUAR NGA 10 CENT/MIN.
WIND
Informacione në wind.it

BOTA SHQIPTARE - Il Mondo Albanese Edizioni - Redazione Viale Marco Polo 119, 00154 Roma - Tel 06.57289240 Fax 06.62209543



Rikthimi i ILIR SHAQIRIT

Në fakt nuk është larguar kurrë, është veç tërhequr nga televizioni për t'iu kush-tuar tërësisht shkollës së vet të baletit dhe familjes. Tani do ta shihni të hyjë sër-ish në ekranin e vogël me një "kalë troje", atë të videoklipit të këngëtares së njohur Alexia ku Iliri është më shumë se thjesht një balerin.



**WESTERN
UNION**
MONEY TRANSFER



www.stranieriinitalia.it
faqet internet të emigracionit

Sipas të dhënave të ministrisë së brendshme deri më 24.00 të datës 30 shtator janë paraqitur 294.744 kërkesa për legalizimin e bashkëpunëtorëve familjare. Kërkesat e paraqitura janë kryesisht për punëtorët për mbajtjen e shtëpisë, të ashtuquajturat colf, 180.408 dhe vetëm 114.336 janë për badante.. Provincat me më shumë kërkesa janë Milano (14,72%), Roma (10,87%), Napoli (8,25%), Brescia (3,81%). Përsa u përket kombësive të punonjësve për të cilët është kërkuar legalizimi, një e katërta e tyre janë nga Ukraina dhe Maroku. Për shqiptarë janë paraqitur vetëm 3,78% e kërkesave apo e thënë ndryshe, për 11.147 bashkëpunëtorë familjarë shqiptarë.

Edhe pse shifra e legalizimeve të kërkuara në përgjithësi është shumë më e ulët nga parashikimi, ajo e shqiptarëve në përgjithësi nuk zhgënjën. Këtë e themi me bindje pasi shqiptarët nuk janë shquar deri më sot si bashkëpunëtorë familjarë, madje kanë dëshmuar në

SANATORIA

vetëm 300 mijë legalizime

Mbyllet sanatoria për bashkëpunëtorët familjare me as rreth 300 mijë kërkesa të paraqitura, prej të cilave vetëm 11.147 për shqiptarë.

këtë drejtim edhe flukset e fundit kur mes dhjetëra mijëra kërkesave për punonjës shqiptarë, për kategorinë colf e badanti, numri i kërkesave ka qenë rreth 7.500. Do të ishte disa herë më e lartë shifra e shqiptarëve që mund të përfitonin nëse legalizimi do të vrente edhe punonjësit e sektorëve të tjerë të ekonomisë.

Ky frenim i kërkesave për legalizim shpjegohet ndryshe nga sindikatat e ndryshe nga ministria e Brendshme. Për shefin e departamentit të imigracionit të ministrisë së brendshme, Mario Morcone, "shumë punëdhënës parapëlqejnë të nxjerrin 500 euro nga xhepat në fund të muajit", ndaj me siguri do të paraqesin kërkesë nga fundi i

shtatorit. Por sipas tij, problemi i vërtetë i bashkëpunëtorëve shtëpiake është një tjetër, "shumë prej tyre punojnë me orë pranë punëdhënësish të ndryshëm, dhe nuk e kanë të lehtë të gjejnë njërin prej tyre që t'i legalizojë". Por në të vërtetë, një gjë e tillë nuk mund të bëhet, të paktën sipas ligjit. Morcone duket sikur thotë që njëri prej

SHTETËSIA ITALIANE

PAGESA E TAKSËS MBI KËRKESAT E SHTETËSISË

Ministria e Brendshme nxjerr menjëherë qarkoren për mënyrën e pagesës së 200 eurove për shtetësinë. Bëhet me anë të një buletini postar në llogarinë rrjedhëse postare nr. 809020 në emër të "Ministria dell'Interno DLCI - cittadinanza"

Me qarkoren e datës 2 shtator ministria e Brendshme bën të ditur që në marrëveshje me Postat Italiane ka aktivizuar një llogari rrjedhëse postare ku mund të derdhin kontributin prej 200 eurosh të gjithë ata që paraqesin kërkesë për shtetësi nga data 8 gusht 2009, siç parashikohet nga paketa e sigurisë. Buletinët postarë për derdhjen e shumës duhet t'i drejtohen llogarisë rrjedhëse me numër 809020 në emër të "Ministria dell'Interno DLCI - cittadinanza" dhe të kenë si motiv (causale) "Cittadinanza - Contributo di cui all'articolo 1, comma 12, lege 15 luglio 2009, N. 94". Edhe pse ministria sqaron se në zyrat e postave do të gjenden formularë të gatshëm për kryerjen e kësaj pagese, në rast se nuk një i tillë nuk gjendet mjafton të merret një

buletin i pastër me tri pjesë (jo me dy) dhe të plotësohet me të dhënat e mësipërme si dhe me emër, mbiemër e adresë të plotë të kërkuarit të shtetësisë. Në momentin e pagesës një pjesë i mbetet postës, dhe dy të tjerat paguesit. Ky i fundit dorëzon njëherë bashkë me formularët e dokumentet e tjera në zyrën e prefekturës ku paraqet kërkesën e shtetësisë dhe ruan pjesën që i mbetet për ta pasur si dëshmi të derdhjes së parave.

Ministria ka përcaktuar gjithashtu edhe mënyrën e pagesës së 200 eurove edhe për ata që paraqesin kërkesë shtetësie nga jashtë Italisë: mund ta bëjnë me anë të një xhirimi parash nga jashtë (bonifiko estero) apo duke përdorur rrjetin evropian të organizatave postare.

MONEY TRANSFER

LEJE QËNDRIMI EDHE PËR TRANSFERTAT E PARAVE

Në fuqi shtrëngimet e paketës së sigurisë për shërbimet money transfer. Klandestinët u sinjalizohen forcave të rendit

Nga 7 shtator shtetasit e huaj pa leje qëndrimi që dërgojnë para me anë të një agjencie money transfer i sinjalizohen policisë. Kanë hyrë në fuqi shtrëngimet për transfertat e parave të paketës së sigurisë. Kjo parashikon që agjencitë e transfertave të parave "të marrin dhe të ruajnë për dhjetë vjet një kopje të dokumentit të qëndrimit nëse klienti që kërkon shërbimin është shtetas jokomunitar".

Po në rast se nuk ka leje qëndrimi? Brenda 12 orëve, agjencitë duhet t'i japin policisë të dhënat personale të personit që ka nisur para. Nëse nuk e bëjnë një gjë të tillë rezikojnë të humbasin licencën.

Sipas Fondacionit Moressa, vitin e shkuar të huajt e Italisë u kanë dërguar familjeve të tyre 6,4 miliardë euro. Këto para janë nisur kryesisht nga Lazio, Lombardia dhe Toscana, ndërsa vendet kryesore ku drejtohen paratë e emigrantëve janë Kina, Filipinet dhe Rumania.

Numri i kërkesave të paraqitura gjatë shtatorit, treguan se nga sanatoria nuk përfituan as gjysma e atyre që mendohej fillimisht. Për arsye të ndryshme, nga kufiri i lartë i të ardhurave minimale të punëdhënësve, minimumi i orarit prej 20 orësh që çdo punëdhënës duhet t'i siguronte punonjësit, çështja e strehimit, kontributet dhe deri te softueri i ministrisë që nxjerr probleme



punëdhënësve të marrë për sipër kontributet për punonjësen shtëpiake duke deklaruar që ajo punon pranë tij, praktikisht edhe gjatë orëve që punon pranë një punëdhënësi tjetër. Në këtë rast punëdhënësi nuk do të bënte tjetër veçse një deklaratë të rreme, të ndëshkueshme me ligj.

Për Assindatcolf, shoqatën e punëdhënësve familjarë, problemet kryesore që po frenojnë senatoren janë të tjera. Janë të shumta pikat kyçe që po i ndërlikojnë jetën familjeve dhe punonjësve, duke i shtyrë atë të

pezullojnë nisjen e kërkesave në pritje të ndonjë sqarimi nga ministria e Brendshme. Sipas Assindatcolf, problemi i parë ka të bëjë me softuerin e ministrisë që nuk parashikon disa situata, si për shembull, rastin kur një bashkëpunëtorë banon në të njëjtën shtëpi me punëdhënësin që ka rezidencë në një vend e qëndrimin e përkohshëm (domicilio) në një tjetër, apo rastin kur kujdestarja asiston dikë që ka rezidencë të ndryshme nga punëdhënësi. Duke përpiluar modularin e kërkesës punëdhënësit i duhet

të japë deklaratë jo të vërteta në mënyrë që programi t'ia pranojë.

Një tjetër pengesë përbëjnë të ardhurat minimale të punëdhënësit. Kjo normë, sipas Assindatcolf-it "nuk merr parasysh rastin - dhe të tilla ka shumë - kur punëdhënësi ndihmohet nga familjarë që nuk bashkëjetojnë me të". Si në rastin e prindërve të moshuar, që edhe pse nuk jetojnë me bijtë, ndihmohet ekonomikisht nga këta të fundit për të punësuar një grua që të kujdeset për ta e për t'i ndihmuar në punët e

shtëpisë.

Një tjetër paqartësi ka të bëjë me kontributet që duhet të paguajnë punëdhënësit për periudhën para 1 prillit 2009, pasi me kontributin prej 500 euro nuk e mbulojnë këtë periudhë. Shumë punëdhënës do të deklarojnë, me siguri, që kanë punësuar bashkëpunëtorin pikërisht më 1 prill apo, maksimumi, 31 mars.

Dhe i fundit është problemi i strehimit. "Procedura e legalizimit - nënvizon Assindatcolf - nuk merr parasysh rastin kur është një i tretë (as punëdhënësi e as punonjësi) që mban në shtëpi, me apo pa qira, të huajin në fazën e legalizimit. Në raste si këto, deklarata e punëdhënësit mbi "strehimin e punonjësit", kthehet në një paditje të mirëfilltë për pronarin e shtëpisë ku qëndron i huaji, pasi i ofron strehim një të huaji të parregullit. Dhe kjo vepër penale nuk pezullohet nga legalizimi". Në fakt, ligji parashikon pezullimin e veprave penale dhe të shkeljeve administrative të punonjësit dhe të punëdhënësit deri në përfundimin e procedurës së legalizimit.

700 mijë nxënës të huaj në bankat e shkollave

Ministria e Arsimit Gelmini lajmëron një reformë për vitin e ardhshëm: "Maksimumi 30% të huaj për çdo klasë". Sipas saj tavani nevojitet për të favorizuar integrimin. Në shkollë do të studiohet gjithashtu edhe qytetaria dhe kushtetuta

Më 14 shtator 2009 ka rënë sërish zilja e orës së parë të mësimin, dhe shkolla italiane e zbulon veten gjithnjë e më multietnike. Sipas studimeve të Karitasit këtë vit do të ulen në bankat e shkollave rreth 9 milion nxënës, disi më pak se një vit më parë, dhe mes tyre do të jenë rreth 700 mijë të huaj. Nëse numri i nxënësve në përgjithësi bie, ai i brezit të dytë të emigrantëve që ulen në bankat e shkollave italiane rritet nga viti në vit me 60-70 mijë vetë. Në lagje të veçanta me përqendrim të lartë të të huajve arrihet në raste ekstreme, si në shkollën Pisacane të Romës që ka 97% të nxënësve me pasaportë joitaliane.

"Në fakt ndodh që në disa klasa prania e nxënësve të huaj i afrohet 100%-shit. Është e qartë që këto kushte shkolla nuk mund të përmbushë detyrën e saj për integrimin e të huajve" u shpreh ditën e parë të shkollës min-

istria e Arsimit Gelmini, që më pas shtoi: "jemi duke punuar për një masë administrative që të parashikojë një numër maksimal të të huajve për çdo klasë, dhe më saktësisht duam që prania e të huajve në klasa të mos kapërcejë 30% të të gjithë nxënësve". Veç kësaj ministria ka shpjeguar edhe futjen në shkollë të një lënde të

re, të edukatës qytetare dhe kushtetuese "në mënyrë që nxënësit italianë dhe të huaj të njohin parimet bazë të bashkëjetesës civile". Megjithatë, kur u diskutua për orën e fesë, ministria Gelmini ngriti zërin krahu Vatikanit në mbrojtje të edukimit katolik, duke u shprehur se "ora fetare në shkollë nuk duhet të jetë multi-konfe-

sionale, por vetëm një orë e thellimit të përmbajtjeve dhe të vlerave të fesë katolike".

Por kjo gjë mund t'u krijojë probleme nxënësve të huaj, numri i të cilëve rritet nga viti në vit qoftë në vlera absolute e qoftë në vlera relative. Numri i nxënësve të huaj është rritur me 700% në dhjetëvjeçarin 1996-2006. Në vitin shkollor 2006-2007 numri i nxënësve të huaj ishte mbi 500 mijë, nga të cilët mëse 78 mijë shqiptarë; në 2007-2008 nxënësit e huaj arritën në mbi 574 mijë, nga të cilët rreth 85 mijë shqiptarë; ndërsa në vitin 2008-2009 (sipas Karitasit) të huajt në bankat e shkollave ishin 630 mijë, shqiptarë mbi 95 mijë. Nxënësit shqiptarë, që deri para dy vitesh përbënin kombësinë më të përfaqësuar mes bankave të shkollave (sot renditen pas rumunëve), kanë kapërcyer sot pragun e 100 mijë nxënësve.

Studio consulenze e servizi

Për informacione lidhur me konvertimin
e patentave shqiptare,
mund të kontaktoni studion në:
konsulenze@hotmail.it
tel/fax. 06 70450741 cell. 333 6036690

Dy veprimtari të shoqatës vatra sjellin dy shkrimtarë shqiptarë para publikut të zonës. Elvira Dones e cila pak ditë më parë kishte marrë pjesë në Festival della Poesia të Mantovas, dhe Ylljet Alicka në Torino, si skenarist e bashkëregjisor i filmit "Kronikë provinciale" shfaqur në kuadër të Festival della Cultura Albanese



Elvira Dones në Asti: "Rrëfej se kam jetuar"

"Rrëfej se kam jetuar". Me këto fjalë, të huazuara nga titulli i librit autobiografik të Pablo Nerudës, poetit të madh amerikano-latin, e nis Elvira Dones paraqitjen e saj përballë publikut të shumtë e të përzgjedhur Italian dhe Shqiptar, që mbushi të hënën, 14 Shtator 2009, sallën kryesore të Bibliotekës së qytetit të Astit, në Itali.

"Edhe unë, si protagonist i shquar i këtij libri," thotë Dones, "kam jetuar në mënyrë shumë intensive. Kam bërë edhe gabime, më shumë se një herë edhe jam rrëzuar, por përherë jam ringritur."

Kjo, natyrisht edhe falë pasionit të thellë për letërsinë.

"Letërsia është për mua si një besim fetar, ajo është vetë feja ime", shprehet shkrimtarja, autore e shumë romaneve, përmbledhjeve me tregime dhe dokumentarëve, të realizuar, në gjuhë të ndryshme, në Shqipëri, Itali, Zvicër e SHBA. "Nëse shkrimtarja Sibilla Aleramo shkruan 'Dua, pra jam', unë, për veten, mund të pohoj pa frikë se 'Shkruaj, pra jam'", shprehet autorja Shqiptare, krijimtaria e së cilës është vlerësuar me çmime prestigjioze ndërkombëtare, si Grinzane Cavour-i i vitit 2008.

Shkrimtare, patjetër, por njëkohësisht edhe grua, bashkëshorte e nënë, Dones flet gjatë edhe për vështirësitë, gëzimet dhe dhimbjet, e lëvrimit

të letërsisë për një grua të përkushtuar edhe ndaj familjes. "Për të shkruajtur letërsi, diçka e cila i përket unit tim më të thellë, kam nevojë për një hapësirë timen, të pacënuar nga asgjë tjetër, që shpesh më mungon" thotë ajo. "Për një shkrimtare femër krijimtaria është më e vështirë, pasi ajo duhet të përkujdeset edhe për familjen. Në rastin tim, kohë nga krijimtaria letrare më rrëmben edhe veprimtaria si gazetare dhe dokumentariste."

Por, pavarësisht vështirësive, Dones duket se preferon të punojë kështu, e impenjuar paralelisht në shumë "fronte". "Më tmerron ideja e të qënit vetëm shkrimtare," thotë ajo. "Është e rrezikshme të tentosh të përshkruash botën pa lëvizur nga skivania e studios tënde. Bota duhet parë, duhet prekur, duhet njohur. Për mua shkrimi i një libri është një moment i shenjtë, dhe gjatë atyre katër muajve që shkruaj bocën e parë, jetoj vetëm për këtë gjë. Por kur përfundoj së shkruari një libër, vijoj menjëherë me

veprimtari të tjera. Puna si gazetare më apasionon. Ajo që më intereson më shumë, si autore dokumentarësh, janë të emargjinuarit. Ata më japin shumë, pasi kur përfundoj një dokumentar kam grumbulluar edhe mjaft material për një libër të ardhshëm."

Nga ideja e një dokumentari ka lindur edhe suksesi i saj i fundit, romani "Vergine Giurata" i botuar në Itali nga shtëpia botuese prestigjioze Feltrinelli. Ky është edhe romani i parë që Dones ka shkruajtur direkt në gjuhën Italiane. "E kam bërë këtë," pohon autorja, "pasi jo rrallëherë kam hasur vështirësi në përkthimin e veprave të mia nga Shqipja në Italisht. Nganjëherë më është dashur madje ti rishkruaj vetë, si në rastin e romanit "Ditë e Bardhë e Fyer".

Projektet për të ardhmen janë të shumta. Një film fiction, një dokumentar, një roman i ri, noir, i shkruar edhe ky në Italisht. Por edhe një përmbledhje me tregime në gjuhën Shqipe, një projekt televiziv mbi letërsinë, i realizuar në

bashkëpunim me Top Channel, si edhe ribotimi në Shqip i romanit "Yjet nuk vishen kështu".

Pavarësisht përmasave të theksuara ndërkombëtare të jetës së saj - me bashkëshort zvicëran, ajo jeton në SHBA dhe udhëton parreshtur për arsye pune - Elvira Dones vazhdon të mbetet shumë e lidhur me vendin e origjinës. "Deri një, apo dy vite më parë, as që e mendoja të kthehesha në Shqipëri," thotë ajo. "Ndërsa tani tek unë po hedh rrënjë ideja, nuk them e kthimit përgjithmonë, por e një vendosjeje të përkohshme, për 4,5 apo 6 muaj, në Shqipëri, për të punuar aty. Shqipërinë e kam dashur dhe vazhdoj ta dua me shpirt. Jam edhe shumë kritike ndaj vendit tim, por kjo vjen pikërisht sepse e dua. Sa herë kthehem në Tiranë kam shumë emocion."

Veprimtaria, e organizuar nga Biblioteka e Astit në bashkëpunim me Shoqatën Vatra të

Torinos, shënoi etapën e rradhës të projektit "Festivali i Kulturës Shqiptare" i propozuar nga Vatra, me mbështetjen e Rajonit të Piemontit. Ajo u pasurua nga buqeta muzikore e ofruar për nder të Elvira Donesit nga këngëtarja lirike Lindita Hisku e shoqëruar nga pianistja Kristina Gjonej.

(vatra)

BOTIM I / EDITORE Edizioni Bota shqiptare srl - (Il mondo albanese)

REDAKSIA / REDAZIONE

Viale Marco Polo 119, 00154 ROMA

Tel 06-57289240 Fax 06-62209543 Cell. 339-3798796

Regjistruar në Regjistrin e Shtypit të Gjykatës së Romës.

BOTA SHQIPTARE È ISCRITTO AL REGISTRO STAMPA DEL TRIBUNALE DI ROMA AL nr. 213/99 del 12/05/1999.

www.botashqiptare.net redaksia@botashqiptare.net

DREJTOR BOTIMI / DIRETTORE EDITORIALE Roland Sejko KRYEREDAKTOR / CAPOREDATTORE Arta Bardhi REDAKTORË / IN REDAZIONE Keti Biçoku, Albana Temali, Marjola Rukaj

NË BASHKËPUNIM ME / IN COLLABORAZIONE CON Edizioni Stranieri in Italia

STAMPA: Centro Stampa Quotidiani S.p.A - via dell'Industria 52 - 25030 Erbusco (BS)

shqiptari i italisë
l'albanese d'italia

e përmuajshme suplement i
Bota shqiptare
gazeta e shqiptarëve në itali

Më 16 Shtator 2009, u shfaq në Torino, për herë të parë në Itali, filmi Shqiptar "Kronikë Provinciale" me regji të Artan Minarollit dhe skenar të Ylljet Aliçkës.

Veprimtaria e organizuar nga Shoqata Kulturore Italo-Shqiptare "Vatra", në bashkëpunim me Associazione 1313 u zhvillua në kuadër të projekteve "Festival della Cultura Albanese", mbështetur nga Regione Piemonte dhe "Cinemainstrada", festivali shëtitës që zhvillohet tashmë prej 6-të edicionesh në Torino.

Karakteristika kryesore e Cinemainstrada është shfaqja e filmave të zgjedhur të kinemasë botërore në gjuhë origjinale, me nëntituj në Italisht, në sheshet e Torinos. Por jo në sheshet-sallone, ato më elegantet, që pozojnë për kartolinat dhe e nuk e zhveshin kurrë uniformën e paradës. Kinemaja e këtij festivali origjinal e krejt të veçantë projektohet në sheshet dhe këndet më të jetuara të qytetit. Ato që gjatë ditës gumëzhijnë nga gjallëria e tregjeve karakteristike dhe ecejaket e njerëzve të zënë me jetën e përditshme.

Më i madhi, më i zhurmshmi,



më i larmishmi e më i bujshmi i këtyre shesheve-agorë, - në Torino e në të gjithë Piemontin, - është padyshim Porta Palazzo.

Nga e Hëna e deri të Shtunën ai është teatër i tregut më të madh ushqimor të qytetit. I mbuluar me tezga dhe i rrethuar nga të katër anët nga dyqane të vogla e të mëdha që tregojnë prodhime nga e gjithë bota, Porta Palazzo është gjithashtu edhe zemra e zonës më të madhe multi-entike të Torinos. Simbol i bashkëjetesës, - jo përherë të lehtë, të qetë e të lumtur, - të popujve e kulturave të ndryshme, Porta

Palazzo është edhe vend-ndodhja e njëres prej xhamive të para të qytetit e të krejt rajonit.

Pikërisht në këtë sfond shumëngjyrësh, jo larg hyrjes së

Kronika Provinciale mbush netët e Festivalit të Kulturës Shqiptare në Torino

xhamisë në fjalë, ku besimtarë të shumtë faleshin për lutjen e mbrëmjes, u shfaq premiera Italgjane e "Kronikës Provinciale". Në të mori pjesë edhe njëri prej autorëve, skenaristi i filmit, shkrimtari Ylljet Aliçka, aktualisht Ambasador i Shqipërisë në Francë dhe pranë Unescos.

Rreth 250 spektatorë të të gjitha moshave e të shumë kombësive e mikpritën përsëdyti Ylljet Aliçkën, që ka debutuar në Torino me "Parrullat", në vitin 2007.

Publiku shijoi dhe duartrokiti humorin e batutave të filmit, pamjet e bukura të sokakëve të Beratit, mjeshtërinë artistike të kastit të aktorëve të përzgjedhur, ku spikasnin emrat më në zë të kinematografisë Shqiptare, risinë e Tedi Papavramit në rolin e ak-

torit, si edhe, natyrisht, interpretimin (dhe bukurinë) e Arta Dobroshit.

Në fjalën e tij përshëndetëse, autori Ylljet Aliçka, pasi falenderoi pjesëmarrësit e shumtë, u shpreh se "nëse ka një vlerë që Shqipëria mund ti japë Europës dhe që mund të pasurojë mozaikun e vlerave Europjane ajo është toleranca fetare."

Kjo duket të jetë vlerësuar edhe nga shikuesit e shumë arabë, nga Maroku, Egjipti, Tunizia, etj., të cilët kundronin kuriozë hoxhën Mirush Kabashi, që ju këndonte në gjuhën e tyre drejtëpërdrejtë nga ekrani i madh. Duartrokitjet e tyre në kor me spektatorët e tjerë shënuan edhe kalimin me sukses të sprovës së shfaqjes së filmit përballë një publiku mysliman.

(vatra)

Mirëserdhët

në shtëpinë tonë.

Dhomë gjumi
BRUNELLA
849€



Paguaj me këste të leverdishme.
Kërkoje financimin në dyqan.

UNIVERSI I KURSIMIT
www.mercatoneuno.com

Më quajnë Gentian Gaba. Vij nga Vlora por prej 8 vjetësh jetoj në Prato me familjen time dhe studioj në Firence.

Vazhdoj studimet e larta për shkencën politike, më saktësisht për 'Studi Internazionali' (marrëdhënie ndërkombëtare)

Meqenëse kam ardhur së bashku me familjarët e mi të cilët punojnë këtu, kam kryer studimet deri në gjimnaz në Prato e më pas zgjedha të studioj në Firence sepse isha informuar se universiteti i Firences për shkencën politike është një nga universitetet më të përgatitura e të specializuara në Evropë.

Pa dyshim jam shumë i kënaqur për zgjedhjen që kam bërë sepse i përgjigjet plotësisht ëndrrave e dëshirave të mia. Nëse dikush do të më kërkonte një sugjerim për shkollën e lartë e sidomos për jashtë shtetit do t'i këshilloja Firencen jo vetëm për sistemin shkollor që funksionon shumë mirë por edhe për mundësitë që u ofron studentëve për të pasur eksperiencë jashtëshkollore instruktive.

Edhe pse mund të duket e vështirë e parë nga një këndvështrim tjetër, është shumë më e thjeshtë ta përjetosh.

Ambienti studentor është i përshtatshëm dhe stimulues.

Për shkak të largimit tim nga Shqipëria në moshë më të vogël nuk kam pasur mundësi të njoh ambientin e studentit në Shqipëri gjithsesi në Itali kam gjetur të gjitha kushtet e duhura për të zhvilluar pasionet e mia

Vitin e fundit kam marrë pjesë në një iniciativë ndërkombëtare, që më dha rastin të isha pjesë e asamblesë së të rinjve të OKB-së. NMUN ishte një mundësi shumë e rëndësishme dhe realiste për të pasur kontakt me jetën e organizatave ndërkombëtare. Ishte shumë domethënëse të merrje pjesë hap pas hapi në punimet e Organizatës, duke filluar nga kurset përgatitore deri tek simulimet e zhvillimet e negociatave ndërkombëtare ndërmjet përfaqësuesve të shteteve. Realizimi më domethënës ishte fitimi i çmimeve duke i dhënë universitetit të Firences një prestigj të paarrtur në konkurset e mëparshme, sidomos për kontekstin ku zhvillohej konkursi, jo vetëm për përgatitjen që duhet të kishim por dhe për lehtësitë e shumë konkurruesve që i përkisnin universiteteve amerikane.



shqiptari

italisë.com

portali i komunitetit shqiptar në Itali

TANI EDHE ONLINE



Nga e majta, studentët Drilona Bramo, Gentian Gaba dhe Afërdita Shani. Vitin e fundit këta tre të rinj - anëtarë të grupit prej 24 studentësh nga universiteti i Firences - kanë marrë pjesë në një iniciativë ndërkombëtare, që u dha rastin të ishin pjesë e asamblesë së të rinjve të OKB-së. NMUN ishte një mundësi shumë e rëndësishme dhe realiste për të pasur kontakt me jetën e organizatave ndërkombëtare. Për të rinjtë ka qenë shumë domethënëse të merrje pjesë hap pas hapi në punimet e Organizatës, duke filluar nga kurset përgatitore deri tek simulimet e zhvillimet e negociatave ndërkombëtare ndërmjet përfaqësuesve të shteteve.

Shpresoj që në të ardhmen të vazhdoj pasionin tim duke u marrë me marrëdhënie ndërkombëtare. Dëshira më e madhe është të përfaqësoj vendin tonë në skenën ndërkombëtare.

Është shumë e thjeshtë të kesh një ekuilibër ndërmjet dy ambienteve përderisa komuniteti i shqiptarëve nuk ka probleme integrimi. Nuk është e mundur të them se frekuentoj më shumë shqiptarë apo italianë, çdo gjë varet nga marrëdhëniet që ke me një person. Tani nuk më bën më përshtypje dhe nuk perceptoj ndryshim nëse një person është shqiptar apo italian.

Kohën e lirë e ndaj mes shoqërisë, palestrës dhe leximit të gazetave ndërkombëtare, etj.

Gjithnjë kam menduar se sfera reale e njeriut është ajo ndërkombëtarja, kufijtë veç blikojnë lirinë e njerëzve, dhe krijimtarinë e tyre. Por jo vetëm kjo, zgjedhja ime është një pasojë e jetës sime. Si një person kozmopolit, kjo degë më lejon të njoh dhe të interpretoj më mirë botën në të cilën jetojmë, dhe në një të ardhme shpresoj që njohuritë e fituara të më lejojnë, të na lejojnë, ta ndryshojmë atë brenda mundësive tona.

Quhem Drilona Bramo. Jam nga Tirana.

Kam zgjedhur të studioj në universitetin e Firences pasi banoj në këtë qytet prej shumë vitesh, së bashku me familjen time. Ndërsa degën e Marrëdhënieve ndërkombëtare e kam zgjedhur sepse më pëlqen politika dhe veçanërisht sfera ndërkombëtare.

Në ambientin e shkollës dhe të universitetit studentet që angazhohen duke studiuar nuk kanë shumë probleme, ndërsa në përgjithësi, studenti i huaj mund të gjejë ndonjë pengesë.

Besoje se Italia në krahasim me Shqipërinë, mund të ofrojë më shumë mundësi për studiuar e më tej edhe për të punuar.

Vitin e fundit kam marrë pjesë në një iniciativë simulimi të Asamblesë së Kombeve të Bashkuara. Bëhet fjalë për

STUDENTËT EMIGRANTËT E ARDHSHËM?

Quhem Afërdita Shani. Jam nga Shkodra (Velipoja), dhe ndihem pasardhësja e një kulture te përzier, të plotë, dhe sidomos të veçantë siç është kultura shqiptare.

E them këtë sepse duke jetuar jashtë vendlindjes shumë here duhet t'i përgjigjemi pyetjes "a quale cultura assomiglia quella albanese?". Përgjigja është asaj shqiptare.

Jetoj ne Pistoia, Toscana që nga viti 1998, me familjen time (Babain, Mamanë, Gjyshen dhe Vëllain). Kam përfunduar Shkollën e mesme të gjuhëve të huaja F. Pacini, dhe pastaj jam regjistruar tek fakulteti i Shkencave Politike, dega Studi Intenazionali në vitin 2005, dhe ne shkurt te 2009-es jam diplomuar. Ndërkohe kam frekuencuar vitin e parë te Magistrales (Master 1) në degën Relazioni Internazionali po tek i njëjti universitet, ku po vazhdoj dhe sot studimet.

Kam zgjedhur universitetin e Firences për një arsye afërsie nga ku jetoj unë, dhe sepse duke qenë e pasionuar pas çdo teme që i përket botës ndërkombëtare, mendoj se

është Universiteti më i mirë në Itali. Jo vetëm për cilësinë dhe bagazhin e studime që domosdoshmërisht te jep por edhe për mundësitë për eksperiencë direkte në fushën tonë. Kështu kam marrë pjesë në një iniciativë simulimi pranë Kombeve të Bashkuara. Përveç kësaj, në vitin 2006-2007 isha me studime ne Francë, ne programin Erasmus per një vit, ne Universitetin IEP (Istituto d'Etudes Politique, Grandes Ecoles) ne Aix-en-Provence, në jug te Francës. Dhe në mars të këtij viti unë dhe 5 shqiptare te tjerë ishim ne Bruksel për një vizitë pranë institucionet evropiane. Të gjitha këto eksperiencë na janë dhënë duke përmbyshur disa kushte universitare.

Personalisht jam shumë e kënaqur nga zgjedhja ime, dhe do t'ja sugjeroja me shumë bindje studenteve nga Shqipëria që duan të studiojnë për të njëjtën fushë. Kjo është e provuar dhe nga fakti se shumë studentë të tjerë që vijnë direkt nga Shqipëria, studiojnë me mua dhe po përfundojnë te njëjtën degë te kënaqur me

zgjedhjen e tyre, madje shumica e tyre kanë vendosur te vazhdojnë dhe specializimet në të njëjtin vend.

Nuk mund te flas personalisht për ato që mund të më ofrojë Italia më shumë se Shqipëria duke qenë se zgjedhja ime për studime ishte vendi ku jetoja. Mbase ajo që të ofron më shumë Italia në degën tonë është të jesh gjithnjë e më shume i përditësuar me çështjet botërore, të bësh kërkime të pafundme, dhe të marrësh pjesë direkt në aktivitetet në shkallë botërore që organizohen vazhdimisht, me një fjale te ecësh "me kohën".

Te jesh student shqiptar në Itali nuk është më keq ose më mirë se të jesh student shqiptar në Shqipëri. Ajo që mund të krijojë probleme në fillim është gjuha, por pasi e kalon këtë vështirësi, cilësia dhe niveli është njësoj si për studentët italianë, mbase angazhimi është më i madh por vullneti i shqiptareve në këtë anë nuk ka munguar asnjëherë. Siç thashë më parë të jesh në të njëjtin hap me botën, do të thotë mos t'ju ndash kontaktit te aktiviteteve dhe çështjeve që ndodhin në botë. Eksperiencë jonë ishte një shembull i kësaj mënyre studimi. Të simulosh një proces diplomatik do të thotë t'i kuptosh personalisht të gjitha anët dhe domethëniet e teatrit ndërkombëtar, të luash rolin tënd dhe të plotësosh kuadrin e përgjithshëm duke i dhënë, mundësisht, një ngjyrë të dukshme shtetit tënd, por dhe që të mos jetë në kontrast me të tjerët.

Normalisht me studimet e mia, çdo aspekt që ka të bëjë me jetën ndërkombëtare do ishte një mundësi pune që unë do ta merrja pa ngurrim. Realizimi më i vlefshëm për mua do të ishte që të punoja për shtetin shqiptar, gjithmonë në degët dhe institucionet e jashtme. Për

Bota shqiptare ka nisur një rubrikë kushtuar studentëve shqiptarë në Itali, për t'i njohur përtej numrave të ftohtë të statistikave të përvitshme. Për të zbuluar nëpërmjet vetë eksperiencës së gjithsecilit jetën e studentëve shqiptarë në Itali, qëllimet e tyre, marrëdhëniet me Shqipërinë e me Italinë, vështirësitë objektive e subjektive, botën e punës dhe përfytyrimin e të ardhmes. Për të pasur një panoramë të segmentuar përtej retorikës përshkruese të klisheve që mbulojnë fenomenin e studentëve në Itali.

momentin ajo që dua është të vazhdoj studimet dhe të përpiqem sa më shumë në punën time duke i dhënë një "valore aggiunto".

Në universitetin tim nuk ka një ndarje "neto" midis italianëve dhe shqiptareve. Por normalisht kur mblidhemi të gjithë shqiptarët bashke duke preferuar të flasim shqip, parapëlqejmë më shumë shoqërinë shqiptare. Mes shqiptareve dialogu është më direkt dhe më i veçantë, mbase ndihemi me shumë si në shtëpi, nuk e kemi atë ndjesinë e konkurrencës së vazhdueshme që mund ta ndjesh më shumë me të huajt. Pra me të huajt normalisht muhabeti vjen tek studimet dhe tek arritjet ndërsa, me shqiptarët është më i larmishëm dhe personal në përgjithësi. Por gjithçka varet nga afriteti që krijohet mes njerëzve. Megjithatë marrëdhëniet e sotshme midis shqiptarëve dhe italianëve është përmirësuar shumë krahasuar me të kaluarën, dhe italianët kanë të njëjtat vlerësime mbi shqiptarët siç kanë ndaj studentëve me kombësi të tjera. Mbase ndonjëherë habiten për arritjet e mëdha të studentëve shqiptarë.

Në kohën e lirë punoj, siç bëjnë dhe pjesa më e madhe e studentëve shqiptarë, personalisht punoj tek një Shkollë "Recuperi anni Scolastici, Benedetto Croce", ku jam mësuese e gjuhëve franceze, angleze, spanjolle dhe e drejtësisë, për studentët që punojnë dhe duan te rikuperojnë vitet e humbura të gjimnazit.

Siç mund të kuptohet nuk kam shumë kohe të lirë, në rast se më tepron dhe pak kohë e lirë preferoj ta kaloj me familjen, me shoqërinë, ose duke lexuar gazeta te ndryshme ndërkombëtare.

një nismë për cilën pjesëmarrësit përzgjidhen ndërmjet studentëve më të mirë të fakultetit të Shkencave Politike. Këtë herë ishim jo vetëm unë por edhe disa shqiptarë të tjerë. Kështu mu dha mundësia për të bërë një eksperiencë të rëndësishme profesionale dhe personale.

Në të ardhmen do të më pëlqente të përdor aftësitë e mia profesionale për zhvillimin e Shqipërisë.

Në ambientin tim universitar, frekuento më shumë italianë, se sa shqiptarë. Sidoqoftë, nga sa di unë, marrëdhëniet ndërmjet këtyre dy komuniteteve janë shumë të mira.

Kohën e lirë e kaloj duke zhvilluar interesat e mia. Kryesisht më pëlqen të dëgjoj muzikë, shikoj filma të ndryshëm, ndjek lajmet e aktualitetit, dhe natyrisht takohem me miqtë e mi.

Albana Temali


Mark Gera është një nga bashkatdhetarët tanë që në Itali ndodhet prej vitit 1992.

Jeton nga ky vit në qytetin e Torinos me familjen e tij, që e solli nga qyteti i Shkodrës ku ish lindur e rritur: Marku është "figlio d'arte" nga prindërit Aleksandër Mark Gera (poet dhe shkrimtar shkodran instrumentist dhe autor i disa këngëve popullore shkodrane) e Luçie Vuksani Gera ("Mësuese e merituar"). Ky ambient artdashës e ndihmoi të kultivonte pasionet e tij mes të cilave edhe piktura nëpërmjet mësimeve të marra nga mjeshtër të mëdhenj të pikturës si Ismail Lulani e më vonë nga Liljana Cefa. Krijimet e tij të para marrin në atë kohë frymëzim nga personazhet "e ndaluara" Disney, kurse më vonë nga piktura moderne dhe mënyra e të shprehurit pop-art.

Ardhja në Itali dhe stabilizimi me punë që nga 1994 në muzetë e Torinos e bënë të gjendet edhe afër ekspozimeve artistike. Kështu, bëhet promotor i ekspozitës së mjeshtrit shqiptar Artan Shabani "Via Egnatia", në vitin 2004 pranë Muzeut të Automobilave ku punonte. Ndërsa gjen rrugën virtuale të prezantojë punimet e tij në internet, në një hapësirë personale tek siti albacenter.it mes artistëve të tjerë shqiptarë që ky sit promovon prej vitësh.

Kjo galeri virtuale është një mundësi për të njohur dhe vlerësuar artin e Gerës, madje aty arrijnë edhe kërkesat për ekspozime. Piktori Alfred Miloti Mirash në rolin e kuratorit, përzgjedh aty një nga punimet e tij me të cilën merr pjesë në Ekspozitën kolektive të artit në Ambasadën Shqiptare në Romë organizuar me rastin e 95-vjetorit të pavarësisë kombëtare.

Pas kësaj vjen ekspozita personale në Alba e inauguruar pak kohë më parë.



MARK GERA "Pikturoj Shkodrën time"

Marku është "figlio d'arte" dhe ambienti artdashës e ndihmoi të kultivonte pasionet e tij mes të cilave edhe piktura për të cilën mori mësime e para nga mjeshtër të mëdhenj në shtëpinë e pionierit të Shkodrës

INTERVISTA

Një ekspozitë personale është ëndrra e shumë artistëve dhe konsiderohet dhe një pikarritje. Ku u inaugurova ekspozita dhe kush jundihmoi në realizimin e saj?

Për mua ka qenë një kënaqësi e veçantë realizimi i kësaj ekspozite personale, e cila u bë e mundur në ambientet e Pallatit të Kongreseve të qytetit Alba. Më ndihmuan në realizimin e saj shokë e miq, në këtë rast miku im Ilir Polena, restauruesi i mirënjohur. Mbërrij te kjo personale pas kolektives në Ambasadën e Romës, ku për mua ishte nder pjesëmarrja, aq me tepër që një punim është përzgjedhur dhe ka mbetur në fondin e Muzeut të Ambasadës.

Me çfarë tematike u paraqitët vijon në faqen 10

Vetëm **15 cent.€/min**
për të telefonuar në **Shqipëri.**
Atdheu yt nuk ka qenë kurrë
kaq afër.



Aktivizo menjëherë No Distance
dhe telefono në Shqipëri me 15 cent.€/min.



 Store | www.tre.it

199 100 700

SHKREHJA E PËRGJIGJES 16 CENT.€, TARIFIMI VETËM MBI SEKONDAT EFEKTIVE TË BISEDËS. OPSIONI NO DISTANCE AKTIVIZOHET ME 0€ PËR 30 DITË E PARA NËSE NËNSHKRUHET GJATË FAZËS SË AKTIVIZIMIT TË NJË SKEDË RIMBUSHËSE 3. NË SKADIM PARASHIKOHET PËRTËRITJA AUTOMATIKE PËR 30 DITË KUNDREJT KOSTOS SË 5€. OPSIONI I VLEFSHËM VETËM NË ITALI NËN MBULIMIN KOMBËTAR TË 3, PËR PERIUDHËN E AKTIVIZIMIT, DHE JO I PAJTUESHËM ME PLANIN RIMBUSHËS SUPER O MONDO, ME OPSIONIN INTERNATIONAL 3 DHE ME PLANET E ABONIMIT. PËR INFORMACIONE MBI MBULIMIN, KUSHTET DHE KOSTOT WWW.TRE.IT OSE 3 STORE.



te kjo personale?

Tematika e punimeve ishte e larmishme edhe pse i kam realizuar në disa vite por shumë ngjarjeve si mërgimi u kam dedikuar disa punime. Po kështu vendlindja, temat sociale etj. Pikturat janë të realizuara në teknikë të përzier dhe vaj në kanavacë me dimensione te ndryshme.

Cilat janë preferencat tuaja në pikturë?

Rymat që parapëlqej janë impresionizmi, kubizmi, pop arti. Ndër piktorët që kam për zemër janë Andy Warhol, Vedova, Lin Delia, I.Kodra. S.Lulani.

Si shqiptar e dashamirës arti keni marrë pjese në shumë aktivitete të shoqatave. Me cilat prej tyre bashkëpunoni?

Në krahinën e Piemontes ku unë banoj ka shumë shqiptarë, të cilët dhe janë organizuar në shoqata. Kryesisht janë shoqata kulturore dhe ndjek vazhdimisht aktivitetet e tyre, por edhe të artistëve të tjerë që punojnë në teatrot apo institucionet kulturore të Torinos dhe zonave përreth. Si shoqata shqiptare që organizojnë aktivitete me cilësi mund të përmend shoqatën "Vatra"-Arbëreshët e Chierit, "Vatra"-Torino, "Mërgimtari" e "Nënë Tereza"-Asti etj. Bashkëpunimet e mia janë kryesisht me shoqatën "Vatra" të Torinos.

Shkodra me objektet historike të saj si Kalaja "Rozafat", Sahati i Inglizit, Ura e Mesit është e pranishme në ekspozitën tuaj. Dëshmi kjo e një lidhjeje të fortë me këtë qytet edhe pse prej shumë vitesh tashmë jetoni në Itali.

Të sjell në pikturë këto objekte të rëndësishme të historisë së një qyteti kaq të lashtë e të dashur për mua si Shkodra ka qenë një veprim i natyrshëm dhe kënaqësi e veçantë gjatë realizimit. Jeta ime

MARK GERA

vijon nga faqja 8



Të sjell në pikturë këto objekte të rëndësishme të historisë së Shkodrës ka qenë një veprim i natyrshëm dhe kënaqësi e veçantë gjatë realizimit. Jeta ime ka rrjedhur pranë këtyre objekteve, pranë Kështjellës, pranë Sahatit

ka rrjedhur afër këtyre objekteve, afër Kështjellës, pranë Sahatit...

Kjo ka qenë edhe një mënyrë prezantimi e një pjese historie të vendit tim, aq të panjohur nga miqtë e mi italianë e jo vetëm. Unë ndodhem në Itali që nga 1992 me familjen time, por që nga viti 2000 çdo vit shkoj për pushime në Shkodër, ku kam lindur e jam rritur, qytet që e kam në zemër si dhe në plazhin e mrekullueshëm të Velipojës, që çdo vit po bëhet më i këndshëm e më evropian.

A do kishit dëshirë të transferonit këtë ekspozitën e Albës në Shkodër?

Kam disa propozime për ekspozimin në Torino, qytetin ku sot jetoj, por edhe nga Shkodra. Shpresoj t'i realizoj të dyja megjithëse duke mos qenë profesionist - pikturoj për qejf - edhe kohën e realizimit të punimeve e kam të reduktuar.

Albana Temali





HELIDON XHIXHA në Art Verona 2009

Skulptori Helidon Xhixha ka ekspozuar nga datat 19 -21 Shtator 2009 (per te dyten here radhazi) ne "ArtVerona" (Ekspozita e Artit Bashkohor e Modern). Veprat e skulptorit shqiptar me origjine nga Durrresi u prezantuan nga Galeria "SpiraleMilano", e cila i kishte renditur keto punime perkrah veprave te autoreve te mirenjohur si Rotella, Vedova, Spoerri, Warhol, Bonalumi ne zones e saj te ekspozimit nr.9 (Padiglione 9). Po ne kete hapshire u vendos nje instalim i rendesishem i realizuar nga Helidon Xhixha. Paralelisht prezantoheshin ky punim dhe te tjera ne hapshiren (show-room) te Artetivù (trasmetuese tv veneziane) realizime te dy viteve te fundit te skulptorit.

Ne mbyllje te ekspozites u be prezantimi i Katalogut me vepra te artistit, i shtepise botuese Skira.

Helidon Xhixha - Energia e shprehur në ngjyrën e zezë (Celik inox 2009), një prej veprave të ekspozuara të serisë së suksesshme "Energjia nëpërmjet ngjyrës"

S shumë herë më ka rastisur, duke u vërdallosur në ndonjë librari shqiptare, të më ketë rënë në dorë ndonjë botim që më është dukur problematik. Ndonjëherë përkthimet janë të dobta dhe nuk i japin rëndësinë e duhur larmishmërisë së shqipes, duke ulur interesin që lexuesi mund të ketë për veprën që ka në duar. Në disa raste botimet janë pirate dhe nuk kanë blerë të drejtat për të botuar librin në shqip. Ka një shumëllojshmëri problemesh që rrezikojnë të ulin dhe cilësinë e atyre që punojnë mirë dhe që natyrisht nuk janë të paktë. Ka raste kur dhe vetë pamja grafike e librit lë shumë për të dëshiruar. Të gjitha këto arsye krijojnë

Tregu i çoroditur i botimeve shqiptare

çorientim tek lexuesi dhe sidomos tek lexuesi i ri që e merr për herë të parë në dorë një autor apo një vepër. Imagjinoni nëse ky lexues njihet bie fjala një

autor italian si Pirandello, nëpërmjet një përkthimi të rëndomtë. Me siguri Pirandello nuk do i pëlqejë ose nuk do ta vlerësojë me rëndësinë që i takon. Nga ana tjetër një nga gjërat që të bën më shumë përshtypje është proporcioni ndërmjet autorëve të huaj që botohen në Shqipëri dhe atyre shqiptarë. Kjo garë fitohet nga autorët e huaj që gjejnë shumë më tepër hapësirë në raftet e librarive.

Kur pyet botuesit për këtë fakt, shumë shpesh përgjigja është se "tregu i lexuesve shqiptarë nuk i tërheq shumë veprat e autorëve shqiptarë". Pjesërisht kjo është e vërtetë, por në të njëjtën kohë duhet të

jemi të ndërgjegjshëm se botuesit nuk bëjnë shumë për të zgjeruar hapësirën e shpirtarëve që shkruajnë. Mungon një punë komplekse e kërkimit të talenteve të reja dhe investimi të ardhurash mbi këto talente. Lexuesi ndonjëherë ka nevojë dhe të udhëhiqet nga dikush në zbulimin e një autori apo shkrimtari. Akoma më shumë nevojë për një letërsi shqipe të pasur me autorë tanë e kanë lexuesit shqiptarë që jetojnë jashtë atdheut. Ky lloj lexuesi në pjesën më të madhe autorin e huaj e lexon në gjuhën e vendit ku jeton, por autorin shqiptar nuk ka se si ta zbulojë nëse dikush nuk e publikon atë.

librialbanesi.it



PROMOZIONE E DISTRIBUZIONE DEL LIBRO ALBANESE IN ITALIA

www.librialbanesi.it

Për çfarëdolloj informacioni, kërkese, opiniononi dhe bashkëpunimi që ka të bëjë me librin shqip, mos hezitoni të na kontaktoni

info@librialbanesi.it Tel: +39 3890939930 Fax: 0575 1949538

POWERCARD

Leverdis sepse flet më gjatë!

MINUTA SHQIPËRI € 10	NGA NUMËR FIKS	NGA NUMËR PUBLIK	NGA CELULAR ITALIE	NGA CELULAR WIND	NGA NUMËR GJEOGRAFIK
SHQIPËRI	180	64	38	70	200
SHQIPËRI, TIRANË	300	82	44	86	320
SHQIPËRI, CELULARË VODAFONE	54	36	26	36	60

Zbulo
leverdinë Powercard
për vendin tënd në
www.powercard.it
ose pranë pikave Sisal

SINERGIA ADV.

tag
KEEP IN TOUCH

Tarifa në fuqi nga 01/09/09 për kartat e
parapaguara prej 10 eurosh, lista tarifore
Powercard ShBA&Europa e TAG International.
Tarifat shpallen në faqet internet www.powercard.it

Informacione në 06 96595959

**POWERCARD ËSHTË NË SHITJE
NË TË GJITHA PIKAT SISAL.**





KTHIMI I ILIR SHAQIRIT

Ilir Shaqiri është një nga simbolet e baletit shqiptar në Itali. Dhe historia e tij ngjason me atë të kolegëve bashkëkombas që kanë zgjedhur të jetojnë e të punojnë në Itali. Por jo në kuptimin e gomoneve dhe historive që përlojnë adoleshentet italiane me dramaticitetin e tyre. Nga programet televizive që katapultuan në rrugën e famës dhe të suksesit të rinjtë shqiptarë, ai u shndër-

rua në një sex-symbol për shumë breza italianësh duke bërë që këta të fundit të zbulojnë një anë të re të shqiptarëve që më parë nuk njihnin. Ilir Shaqiri bën pjesë në grupin e pikërisht atyre shqiptarëve të cilëve u takoi barra e rëndë të çajne përpara në një vend të huaj në profesionin e tyre e njëkohësisht të jepnin e të merrnin me periudhën më të vështirë të shqiptarë-fobisë italiane, duke e pasur këtë fil-

Në fakt nuk është lartguar kurrë, është veç tërhequr nga televizioni për t'iu kushtuar tërësisht shkollës së vet të baletit dhe familjes. Tani do ta shihni të hyjë sërish në ekranin e vogël me një "kalë troje", atë të videoklipit të këngëtares së njohur Alexia ku Iliri është më shumë se thjesht një balerin.

limisht si pengesë e më pas si flamur, si sfidë për të motivuar jetën e tyre mediatike. Dhe rezultati ishte i admirueshëm. Ndërsa kohëve të fundit angazhimi social që arti dhe fama mund t'i lejojnë vetes, duke kontribuar në përcjelljen e mesazheve që kanë fuqinë të përmirësojnë gjërat. Pasi shqiptarët dolën disi nga lsisita e zezë, me gjithë shkaqe e pasojat politologjike

RIKTHIMI I ILIR SHAQIRIT

vijon nga faqja 13

që kjo dalje pati, fama dhe personaliteti i Ilir Shaqirit i janë dhënë një beteje më unviersale, kundër racizmit në përgjithësi, kundër luftimit të më të dobtëve e të ndryshmeve që ka pllakosur Italinë kohëve të fundit. Gjithmonë baleti, vallëzimi janë mjetet me të cilat komunikon balerini shqiptar por këtë herë natyra e tij e zakonshme gërshetohet me një zhanër të ri në një videoklip, që do të shërbejë si habitat viziv i këngës më të fundit të Alexias. Një këngë kundër racizmit, kundër diskriminimit në përgjithësi. Por që do të jetë edhe një copë e vogël viedo-arti, ku përgjegjësia kryesore i takon pikërisht balerinit shqiptar. I ambientuar në katakombet e Ponzianos, videoklipi konsiston në një balet mbi sipërfaqe të vështirë, ndërsa mjetet skenike janë të pasura me simbolikë, aq sa videoklipi të renditet ndër punët më të mira të kësaj gjinie në Itali. Dhe kjo kuptohet do t'i sjellë akoma më shumë famë balerinit shqiptar ndërkohë që edhe emri i tij, talenti dhe cilësia i kanë shtuar jo pak vlerë videos që do të shfaqet me siguri bujshëm televizioneve italiane siç ndodh rëndom me videot e këngët e Alexias.

ma.ru.

Iliri me të shoqen, aktoren Emanuela Morini, dhe të bijën Emily. Në faqet pasuese fotot janë të gjitha nga sheshxhirimi i videoklipit të këngës "E non sai" të Alexias.



„ Një këngë kundër racizmit, kundër diskriminimit në përgjithësi. Por që do të jetë edhe një copë e vogël viedo-arti, ku përgjegjësia kryesore i takon pikërisht balerinit shqiptar.

INTERVISTA

nga Marjola Rukaj

Shqiptari i Italisë: Në çfarë konsiston bashkëpunimi me Alexian?

Ilir Shaqiri: Ky është bashkëpunimi i parë që marr përsipër në drejtimin e videoklipeve. Edhe pse më parë kisha

marrë disa oferta për videoklipe duhet të them se ky ka qenë një terren ende i pashkelur për mua dhe si i tillë oferta e Alexias mu duk jashtëzakonisht premtuese dhe joshëse. Kjo e Alexias ishte diçka shumë e veçantë mbi të gjitha sepse mënyra se si u realizua ky videoklip ka bërë të mundur që të dalë në pah një punë artistike shumë cilësore. Është një punë ku regjia përputhet jashtëzakonisht mirë me protagonistët. Alexia është këngëtarja dhe autorja e këngës, ndërsa unë jam balerini kryesor. Përveç kësaj është edhe një personazh shumë interesant që quhet Madame Fifi, është një transeksual që është i njohur në Itali e në

Evropë sepse është tejet aktiv për problematikën e transeksualëve. Ky videoklip lançon mesazhe shumë të rëndësishme kundër racizmit dhe diskriminimit në përgjithësi përfshirë këtu katgeori nga më të ndryshmet që e gjejnë veten si viktime të këtij fenomeni. Kjo ishte tema së cilës iu mëshua gjatë konferencës së shtypit që dhamë për këtë këngë në Milano para pak kohësh. Bëhet fjalë për një këngë që merret me diskriminim jo vetëm ndaj transeksualëve por edhe ndaj kategorive më të gjera si për shembull emigrantëve, e të tjera pakicave të emargjinuara të cilat çuditërisht edhe pse jemi pothuaj në 2010 janë ende tejet të diskriminuara e në vështirësi nga grupe të ndryshme njerëzish që mbajnë qëndrime kaq të dënueshme. Është absurde sepse jetojmë në një kohë kur edhe kufijtë humbasin kuptim dhe të ndryshmit kanë mundësi të komunikojnë mes tyre prandaj vjen vetiu logjika se njerëzit duhet të ishin më të mësuar me tjetrin, me të ndryshmin, por kjo nuk ndodh.

Si është konceptuar videoklipi?

Është një punë shumë e bukur regjizoriale dhe skenografike. Mjafton të përmendet fakti se Alexia futet brenda një topi prej qelqi dhe unë duhet të përpiqem ta tërheq e ta shtyj jashtë katakombëve që ishin si skenë e xhirimit. Kemi xhiruar në katakombet afër Romës që janë disa hektarë, një sipërfaqe mbresëlënëse që nuk mbaron kurrë. Ishte një punë jashtëzakonisht e bukur, dhe jam shumë i lumtur që mora pjesë. Si balerin kam marrë shumë sodisfaksion dhe si unë edhe trupa e xhirimit me të cilët kam mbetur në marrëdhënie të shkëlqyera. Por natyrisht ishte një punë shumë e vështirë, për shkak të terrenit dhe mu desh të kërceja edhe zbathur, sepse emocionet ishin kaq të forta, dhe kënga ishte shumë e bukur, sa që ndjeva nevojën të ndieja direkt atmosferën duke prekur truallin zbathur.

Pra videoklipi ishte një përmasë e re e paeksploruar?

Po, ishte një sektor i ri ku nuk kisha punuar më parë dhe ku pashë se punohej ndryshe nga ç'isha mësuar të punoja. Për shembull fakti që për një skenë



duheshin bërë një mori e pafundme provash. Cdo herë ko-reografia më dukej si një interpretim që cdo herë që kërceja më dukej ndryshe nga e mëparshmja. Ishte një eksperiencë shumë e bukur. Ky videoklip do të hyjë tek Netët e videoklipit që zhvillohet në Romë, sepse është me të vërtetë me një punë e realizuar


me shumë cilësi teknikisht. Nga ana tjetër nëpërmjet disa teknikave të veçanta që do të përshpejtojnë në maksimum lëvizjet e balerinit kështu që është diçka edhe eksperimentale si të thuash, ndërsa në momente të tjera do të ketë përngadalësim. Jam shumë kurioz edhe unë ta shikoj se si do të ketë dalë ky videoklip. Për më

Ky videoklip do të hyjë tek Netët e videoklipit që zhvillohet në Romë, sepse është me të vërtetë me një punë e realizuar me shumë cilësi teknikisht. Nga ana tjetër nëpërmjet disa teknikave të veçanta që do të përshpejtojnë në maksimum lëvizjet e balerinit kështu që është diçka edhe eksperimentale si të thuash, ndërsa në momente të tjera do të ketë përngadalësim. Jam shumë kurioz edhe unë ta shikoj se si do të ketë dalë ky videoklip. Për më tepër në këtë videoklip merr pjesë edhe vajza ime e vogël

teper në këtë videoklip merr pjesë edhe vajza ime e vogël e cila në një pjesë të videoklipit i jep një margaritë të kuqe madam Fiftisë. Është një simbol paqeje. Besoj se kjo skenë do të dalë në fund të videoklipit. Kjo është diçka që më ka emocionuar shumë. Po ishte pikësëpari vlerësimi që kam

vijon në faqen 16





RIKTHIMI I ILIR SHAQIRIT

vijon nga faqja 15

për Alexian, këngët e së cilës i kam kërcyer shpesh herë në Amici, apo Buona Domenica. Ndërsa këtë herë ishte edhe një arsye sociale sepse u angazhova për një çështje që shqetëson jashtëzakonisht shumë Italinë e sotme.

Ky i yti ka qenë kështu një angazhim social? Nuk është hera e parë që ti angazhohesh për të tilla tema? Arti mund të bëjë diçka për të përmirësuar gjërat dhe kundër fashizmit që ka pllakosur Italinë?

Pa diskutim. Arti është diçka shumë e fuqishme. Unë besoj në vërtetësinë e asaj fjalës së urtë shqiptare se fjala vret më shumë se plumbi. Nuk dua të flas me superlativa për vetenn dhe shokët e mi por kontributi që artistët shqiptarë kanë dhënë në Itali për njohjen dhe përmirësimin e imazhit të shqiptarëve është i pamohueshëm sepse kanë treguar se kush janë shqiptarët në të vërtetë. Tani është krejt tjetër gjë të thuash që jam nga Shqipëria. Dikur nuk ishte

”
Kontributi që artistët shqiptarë kanë dhënë në Itali për njohjen dhe përmirësimin e imazhit të shqiptarëve është i pamohueshëm sepse kanë treguar se kush janë shqiptarët në të vërtetë. Tani është krejt tjetër gjë të thuash që jam nga Shqipëria. Dikur nuk ishte kështu.

kështu. Kjo mendoj se vjen si pasojë e kontributit që këta artistë kanë dhënë. Sot kur thua që je nga Shqipëria njerëzit nuk imagjinojnë më atë gogolin që imagjinojnë dikur. Megjithëse unë për vete nuk e kam përjetuar kurrë këtë lloj racizmi e di shumë mirë se sa e vështirë ka qenë pasi e kam vënë re tek të tjerët dhe shumë shokë të mi më kanë folur për këtë. Besoj se kam qenë një përjashtim fatlum për shak të profesionit që kam dhe padyshim të famës së mirë që ky lloj profesioni të jep. Sot shqiptarët më duken të qetë dhe në harmoni me vetëveten, dhe nuk e fshehin më identitetin e tyre. Arti ka ndihmuar në ndryshimin e një mendësie të gabuar. Unë sot kur them që jam nga Shqipëria mendoj se kam avantazhe. Më thonë: "ah po ju shqiptarët jeni balerinë të shkëlqyer". Kështu kjo mund të vlejë edhe për rumunët. Sidoqftë unë gjithmonë kam luftuar kundër racizmit dhe edhe kur e kam perceptuar i jam kundërvënë dhe nuk e kam lejuar që të ekzistojë. Cdo njeri ka personalitetin e vet dhe kjo duhet nxjerrë në pah.

Ke qenë ndër Shqiptarët e parë që kanë ardhur në Itali të bëjnë balet. Duke u kthyer pas si mendon çfarë të ka dhënë Italia?

Italia më ka dhënë shumë. Natyrisht nga pikëpamja profesionale. Por mbi të gjitha më ka dhënë një familje të mrekullueshme që është maksimumi që një njeri mund të kërkojë nga jeta. Kam një grua italiane dhe një fëmijë të mrekullueshëm. Jam shumë i lidhur me Italinë dhe do të vazhdoj të jem i lidhur, pikërisht sepse kam këtë familje të mrekullueshme. Po të ishte ndryshe ndoshta do të isha i tunduar nga ndonjë shtegtim për disa kohë në Gjermani, Francë, ShBA apo diku tjetër siç bëjnë në përgjithësi njerëzit e palidhur. Italia më ka dhënë të gjitha gjërat që vetëm njerëzit fatlumë mund të kenë. Pastaj natyrisht më ka dhënë një karrierë, një punë shumë të mirë që është ajo për të cilën kam pasur nevojë. Po të bëja një bilanc do të thoja se jam shumë i kënaqur nga ajo që kam arritur. Gjithçka që kam arritur ka qenë

vijon në faqen 19



MOS I VËR KUFIJ ZËRIT TËND.

Mjaftojnë 10 qindarka për t'u ndier në shtëpi.

Aktivizo Call Your Country: flet me Shqipërinë duke filluar nga 10 qindarka në minutë. Madje, me Noi Wind, me vetëm 6 euro në muaj mund të flasësh falas me të gjithë celularët Wind për 200 minuta në muaj.

Aktivizim falas për të gjithë klientët e rinj deri më 11 tetor 2009.

Call Your Country ka kosto gjashtëmujore prej 4 eurosh. Tarifa drejt celularëve është 10 qindarka në minutë. Impulsi i përgjigjes 15 qindarka. Tarifimi çdo 60 sekonda. Për informacione www.wind.it



WIND

abonohu në

Bota shqiptare

GAZETA E SHOIPTARËVE NË ITALI

fituese e çmimit m.souhir 2005 të gazetarisë italiane si "gazeta më e mirë për të huajt në itali"

"Bota shqiptare" është prej dhjetë vitesh i vetri zë në gjuhën shqipe në shtypin italian
"Bota shqiptare" botohet nga e vetmja shtëpi botuese në gjuhën shqipe në Itali
"Bota shqiptare" nuk ka përfituar e nuk përfiton asnjë kontribut financiar publik italian apo shqiptar.
"Bota shqiptare" është e pavarur dhe jeton vetëmsajë shitjeve, abonimeve dhe reklamave

PAJTOHU PËR VETE
apo për t'ia bërë dhuratë një miku

abonimi për një vit (22 numra)

€ 35.00

ABONIMI MUND TË FILLOJË NË ÇDO PERIUDHË TË VITIT
PAGESA KRYHET PRANË ÇDO SPORTELI TË POSTAVE ITALIANE
nëpërmjet derdhjes së një buletini postar pagese
në llogarinë postare (conto corrente postale)
nr. 16831018 në favor të BOTA SHQIPTARE

Telefono në redaksi dhe kërkto të të nisimnumin e parë bashkë me fletën e abonimit të plotësuar.
Më ta marrë, të mbetet veç të shkosh në postë për të paguar.



BOTA SHQIPTARE, VIALE MARCO POLO 119, 00154 ROMA

REDAKSIA DHE SHËRBIMI I ABONIMEVE TEL 06-57289240 - FAX 06-62209543 - CEL. 339-6426836

redaksia@botashqiptare.net

RIKTHIMI I ILIR SHAQIRIT

vijon nga faqja 16

me punë e me përpjekje të vazhdueshme, por më është dhënë mundësia dhe gjithçka ka ardhur në momentin e duhur, pa asnjë lloj sforcoje pa asnjë lloj kompromisi.

Po pse erdhe pikërisht në Itali?

Para se të vendosja të transferohesha e kisha vizituar Italinë edhe shumë herë të tjera, nëpërmjet shfaqjeve kulturore. Kisha udhëtuar shumë edhe para se të vendosja të vija në Itali. Italinë e kisha parë disa herë dhe ndoshta ngaqë njihja gjuhën, nga që ishte shumë afër me Tiranën. Mendoja se që të shkosh nga Roma në Tiranë nevojiten vetëm 50 minuta, koha sa të ngrihet avioni, dhe nuk doja të shkoja në një vend të largët, më dukej e tmerrshme të largohesha kaq shumë nga familja ime. Pastaj është edhe fakti se njerëzit janë shumë të butë dhe kam pasur shumë përkrahje. Kam qenë me shumë fat në këtë drejtim sepse kam gjetur njerëz që më kanë ndihmuar e më kanë lehtësuar shumë jetën prej migranti veçanërisht në fillim që e dinë të gjithë se është diçka shumë e vështirë. Për më tepër ne shqiptarët në atë kohë ishim edhe shumë të padalë kështu që ishte një eksperiencë dy-fish e vështirë. Italia na dukej si diçka jashtëtokësore. Më kujtohet kur shkova për herë të parë në stacionin Termini, në Romë dhe u çudita, i thoja vetes: o zot çfarë janë gjithë këto shina, nga duhet të hyj e nga duhet të dal unë këtu? Pastaj qëllimi i ardhjes sime këtu ishte baleti, në '93 filloi Corrida e Corrados dhe që aty fillova të punoj. Dhe më vonë erdhi edhe rikthimi në teatër. Kam punuar edhe me koreografë të mëdhenj siç është për shembull Gino Landi. Tani jam duke vënë në skenë një opera jo shumë të gjatë por që është diçka për qeverinë italiane dhe qeverinë e Katarrit të cilët kanë një përfaqësi në Venecia. Duhet të japim shfaqje në teatrin La Fenice që është për mendimin tim teatri më i bukur në Itali. Kënaqësia është që jam balerin i parë, trupa përbëhet nga 35 balerinë. Është një punë shumë e mirë. Dhe mbi të



Me Shqipërinë vazhdoj të kem marrëdhënie afektive shumë të forta, edhe pse prindërit e mi jetojnë tashmë në Itali, e madje mamaja ime që është edhe ajo balerinë jep mësim në akademinë time. Por Shqipëria më mungon shumë dhe sa herë që kam mundësi shkoj në Tiranë bashkë me babain.

gjitha mu realizua një ëndërr sepse unë vërtetë kisha ëndërr të vizitoja teatrin La Fenice të Venecias sepse është teatri më i bukur në Itali. Është ëndërra e çdo artisti të hipë dhe të shkelë në atë skenë?

Më mirë skena e një teatri apo prozhektorët e televizionit?

Pyetja është shumë e bukur. Tingëllon sikur të thuash, do që të të presin dorën e majtë apo dorën e djathtë. Nuk jam në gjendje të zgjedh një nga këto të dyja dhe të lë tjetrën. Televizionet kanë të mirën që kanë shumë shikueshmëri dhe kështu mesazhi u mbërrin shumë njerëzve kurse skena e teatrit është magjike, të merr me vete, të rrëmben me atë magjinë e saj dhe të bën që të mos duash të ndalosh më, të vazhdosh të kërcesh në pafundësi.

Ndërsa cilat janë marrëdhëniet e tua me Shqipërinë pas gjithë këtyre viteve?

Vazhdoj të kem marrëdhënie afektive shumë të forta, edhe pse prindërit e mi jetojnë tashmë në Itali, e madje mamaja ime që është edhe ajo balerinë jep mësim në akademinë time. Por Shqipëria më mungon shumë dhe sa herë që kam mundësi shkoj në Tiranë bashkë me babain. Ndërsa nga pikëpamja e punës është vështirë të thuash sepse në Shqipëri nuk kam arritur të realizoj asgjë pasi atje ka një mentalitet shumë përngadalësues, i nisin gjërat dhe i lënë në mes. Kështu funksion Shqipëria sot, do të vrapojë por ka diçka që e mban të lidhur në vend numëro.

vijon në faqen 20



RIKTHIMI I ILIR SHAQIRIT

vijon nga faqja 19

Por bën pjesë Shqipëria në projektet e tua për të ardhmen?

Po pa diskutim e me shumë kënaqësi. Por nuk ka projekte konkrete. Do të më pëlqente për shembull të organizoja diçka në Shqipëri, do të doja për shembull të krijoja një kompani balerinësh shqiptarë që janë shumë të vlerësuar kutphet.

E ndjek jetën artistike në Shqipëri?

Po e ndjek nëpërmjet Digitalb-it. Duhet thënë se është përmirësuar jashtëzakonisht, por ka një mënyrë kopjimi shumë banal të programeve italiane. Për kulturën dhe mentalitetin që ka Shqipëria nuk u përshtaten këto lloj formash. Duhet gjetur gjëra më origjinale që të përputhen me kulturën shqiptare. Kanë marrë emisionet Zelig, Amici, Maurizio Costanzo Show, e i kanë përkthyer në shqip. Ka gjëra origjinale por shumë gjëra janë pa kripë. Nuk kuptoj pse nuk sforcohen të gjejnë diçka origjinale.

Ndërsa nuk jam shumë i informuar për teatrot sepse ato nuk ndiqen nga televizionet.

Nga se vjen kjo cilësi e balerinëve shqiptarë në Itali? Diçka kulturore?

Jo nuk është një koncept i tillë. është diçka reale. Ka shumë balerinë që thjeshtë nuk duken për shumicën e njerëzve sepse kërcejnë vetëm në teatër. Unë njoh balerinë të jashtëzakonshëm shqiptarë, që kanë një potencial artistik që nuk e kanë meshkujt italianë. Ka të bëjë me traditën që ka pasur shkolla e baletit shqiptar. Them ka pasur sepse nuk më duket se vazhdon të jetë. E them këtë sepse kam parë disa baletë kur kam qenë në Tiranë, vënë në skena nga balerinët e akademisë dhe të them të drejtën me ndonjë përjashtim të vogël kanë qenë zhgënjes, të shkordinuar plotësisht. Ndërsa brezi im, i Anbetës, apo Kledit ka pasur profesorë të apasionuar që kanë studiuar tek Bolshoj. Ne jemi formuar në kushte tmerrësisht të vështira, nuk kishim as ujë të ngrohtë, e bënim dushin ditë për ditë në temperaturën -2. Kështu arti përcillet me ngulm



”

Akademia ime e baletit quhet Etoile d'Ilir. Këtë projekt e kam pasur gjithmonë shumë për zemër. Japim mësim lloje të ndryshme baleti, ku nëna ime jep baletin klasik, unë atë bashkëkohor dhe kemi edhe shumë zhanre të tjera.

sepse ose do ta merrje atë diplomë e të ishe i pari i klasës që të arrije të punoje në teatrin e operas, o ishte e kotë gjithçka. Ndërsa sot kanë koncepte të reja. Nga ana tjetër nuk kemi parë më balerinë të rinj të talentuar që të vijnë këtu, e kam fjalën për shembull për 18 vjeçarët.

C'rol luan në këtë humbje fakti që shumë prej balerinëve më të talentuar kanë emigruar?

Brezi im ka emigruar sepse e vetmja mundësi që të jepej në Shqipëri ishte një rrogë e thjeshtë në teatrin e operas dhe baletit. Unë ika kur filluan të bënin balet modern. Gjë që për shembull edhe sot e kësaj dite në Shqipëri nuk ekziston, sepse në Shqipëri nuk mëso-

het baleti modern. As sot bazat e baletit modern në Shqipëri nuk ekzistojnë. Dhe kur shqiptarët bëjnë balet modern është shumë interesante të shikosh se sa të kopjuara duken. Por jo gjithmonë kopjimet dalin bukur, dhe është për të ardhur keq që vazhdojnë me këto lloj mangësisrash.


Po si ke hyrë në botën e baletit?

Ishte diçka më se logjike sepse të dy prindërit e mi janë balerinë. Nëna ka qenë balerinë e parë e teatrit të operas dhe baletit kurse babai ka qenë solist. Kështu që jam rritur me këtë botë dhe erdhi shumë natyrshëm që edhe unë të bëhesha balerin.

Ndërsa Akademia jote e baletit ecën më së miri...

Po, quhet Etoile d'Ilir. Këtë projekt e kam pasur gjithmonë shumë për zemër. Japim mësim lloje të ndryshme baleti, ku nëna ime jep baletin klasik, unë atë bashkëkohor dhe kemi edhe shumë zhanre të tjera. Kjo lloj pune të jep jashtëzakonisht shumë kënaqësi. Veçanërisht është një kënaqësi e madhe kur zbulon talente që më pas vazhdojnë seriozisht këtë rrugë. Për mua është edhe diçka emocionale sepse kthehem mbrapa kur isha edhe unë në moshën e tyre dhe më duket edhe mua vetja i vogël.

Bisedoi Marjola Rukaj




FLET NË BOTË ME PAK



WIND

NËSE KE CELULAR ME SKEDË RIMBUSHËSE, ME 5 EURO NË MUJ MUND TË TELEFONOSH NË ITALI NGA JASHTË SAJ DHE TË MARRËSH TELEFONATA ME VETËM 15 QINDARKA NË MINUTË, PAS MINUTËS SË PARË TË BISEDËS. PËR TË AKTIVIZUAR **EASY ROAMING** DËRGO NJË SMS NË NUMRIN FALAS 4033 ME TEKSTIN EASY ROAMING SI

PËR INFORMACIONE WWW.WIND.IT





Që sot familja është më pranë teje

me ISI Sponsor dhe ISI Medical
mund të sjellësh në Itali
personat që do.

Policat e sigurimit ISI Sponsor dhe ISI Medical janë të domosdoshme për të gjithë ata që duan të hyjnë në Itali.

Për më shumë informacion, për të njohur dyqanet që shesin produktet ISI Insurance ose për të blerë drejtpërdrejt policat ISI Sponsor dhe ISI Medical vizito faqet internet ose telefono në call center.

Mund t'i gjesh vetëm në pikëshitjet më të mira  

www.isiinsurance.it

tel: 06.3215205

Mesazh publicitar me qëllim promovimi. Për kushtet e kontratës mund të konsultohen fletët informuese të bashkëngjitura policës ose të vëna në dispozicion pranë pikave ISI Insurance ose në faqet internet www.isiinsurance.it. Drejtimi dhe Koordinimi Gruppo Arca Vita SpA

 Insurance

Kompania e Sigurimit e Qytetarëve të Rinj



FJONA ÇAKALLI

Nga pasioni për baletin, te biznesi i këpucëve të baletit

Është vetëm 22 vjeç, por e bija e dyshes së famshme të balerinëve Ludmill Çakallit dhe Tania Sulejmani, po tregon talentin e saj përtej baletit, në një biznes që ka tërhequr edhe vëmendjen e Il Sole 24 Ore nga ku është marrë intervista e mëposhtme

Fjona Çakalli është një bukuroshe 22-vjeçare shqiptare e transferuar në Itali bashkë me familjen kur ishte vetëm tre vjeç. Në pamje të parë është si shumë e shumë bashkëmoshatare të vetat, por në të vërtetë ka një veçanti, jo të papërfillshme: është sipërmarrëse që ka kthyer pasionin e saj për baletin në një biznes novator. Sot firma e saj - Fjorick - është titullare ekskluzive për Italinë e licencës Hello Kitty për prodhimin e këpucëve të për vallëzim. Historia e Fjonës përcjell një sinjal konkret: idetë e mira mund të të vijnë në çdo moshë.

Fjona, ke ardhur në Itali në moshën trevjeçare, si ndodhi?

Familja ime është e lidhur prej një jete me botën e baletit (Fjona është e bija e balerinit të njohur Ludmill Çakalli). Babai im ka qenë balerin i parë në Operën e Tiranës: kur pati disa oferta pune qoftë nga Scala e Milanos, qoftë nga shkolla baleti prestigjioze të Italisë së Veriut, vendosi që të gjithë do të kishim një të ardhme më të mirë dhe më shumë mundësi këtu.

Pra vallëzimi është pasion i yti.

Mund të them që vallëzimi është pjesë e jetës sime. Edhe unë vetë, që kur isha gjashtë vjeçe, kam kërcyer dhe ëndrra ime ishte të bëhesha balerinë klasike. Fatkeqësisht, sipas tim eti - që ishte edhe maestroja im - nuk kisha "phisque du role" për t'u bërë balerinë klasike profesioniste, ndaj gjithnjë e kam kultivuar vallëzimin, baletin vetëm si pasion.

Dhe nga ky pasion lindi një biznes, na trego pak.

Qysh e vogël, përveç pasionit



për vallëzimin, kam ushqyer interes të madh për të kuptuar se si krijohen objektet e ndryshme. Më kujtohet që shkoja në supermarketë me prindërit dhe pyesja se si bëheshin gjëra të caktuara, sa kushtonte t'i prodhoje e si bëhej për t'i nxjerrë në treg. Prindërit e mi ishin vërtet të çuditur nga këto pyetje të mia! Më pas, duke u rritur kam ndier gjithnjë më të fortë dëshirën për të krijuar diçka timen, që të lindte prej meje, por ishte një ide për të cilën nuk arrija të gjeja mënyrën e duhur për ta vënë në jetë.

Por takove Riccardon dhe...

U njoha me Riccardon në vitin 2007 dhe ishte vërtet dashuri me shikim të parë! Ishim në sintoni për gjithçka, e mbi të gjitha që të dy donim të krijojmë diçka që ishte e jona. Ai kishte edhe më parë përvojë sipërmarrëse - importonte gadget nga Japonia - ndaj e kuptonte mirë dëshirën time dhe kishte më shumë mjete për ta realizuar. Në fillim mendonim të zgjeronim aktivitetin e tij, por kur e njoha me botën e vallëzimit, ndërroi mendim sepse e kuptoi që mund të kishim mundësi të reja.

Si të lindi ideja të prodhoje këpucët për Hello Kitty?

Ishim një mbrëmje për darkë me prindërit e mi, po diskutonim si të vinim në punë përvojën që Riccardo ka me Japoninë dhe filluam të bënim një sërë "lidhesh të rastësishme": në Japoni marka Hello Kitty është shumë e fuqishme, në Itali është shumë e njohur dhe e dashur, në vallëzim nuk ekziston asgjë që të ketë një markë të tillë (ekzistojnë vetëm markat e veshjeve sportive), ka shumë gra - dhe shumica e atyre që vallëzojnë janë gra - që blejnë objekte të kësaj marke sepse u pëlqejnë... në fund të mbrëmjes lindi ideja: t'i kërkojmë licencën për të prodhuar këpucë vallëzimi Sarrio-s, firmës shumëkombëshe që ka edhe Hello Kitty-n.

Po më pas si veproje?

Fluturova për në Japoni me Riccardon dhe i paraqita idenë time Sarrio-s: u pëlqeu menjëherë sepse nuk kishin asgjë të ngjashme dhe nuk ishin të pranishëm në këtë treg. Kështu, megjithëse e re në moshë e nuk kisha shpatullat të mbrojtura nga ndonjë shumëkombëshe, më dhanë besim dhe licencën ekskluzive për prodhimin e këpucëve për vallëzim në Itali. Në atë moment isha e

vijon në faqen 24

bindur që pjesën më të vështirë e kisha hequr, por gabohesha sepse atëherë më filluan problemet. Në radhë të parë doja të realizoj një produkt 100% "made in Italy", por nuk qe e mundur sepse asnjë nuk pati besim tek ne: na kërkoi çmime tejet të larta dhe sasi magazine të papërbalueshme për një ndërmarrje të vogël si e jona. Kështu vendosëm të bëjmë vetëm design-in në Itali dhe të prodhojmë gjithçka jashtë shtetit. Kjo na mundëson të kemi një produkt të shkëlqyer me design e kujdes italian por me kosto më të ulët: kështu mund të mbajmë çmime të arsyeshme për këpucët tona, duke u dhënë të gjithëve mundësinë për t'i pasur një palë.

Këpucët kanë edhe veçori të tjera?


Po. Jo vetëm janë të parat e markës Hello Kitty, ekskluzivisht për vallëzimi, por edhe janë menduar e realizuar për të qenë eko-kompatibël. Në fakt, një pjesë të këpucëve klasike të baletit - zakonisht të

FIONA ÇAKALLI, nga pasioni për baletin te biznesi i këpucëve të baletit

vijon nga faqja 23

realizuar me lëkurë vçi- është bërë me lëkurë ekologjike, material specifik që respekton ambientin dhe që, në nivel teknik, nuk ka asnjë dallim nga lëkura e vërtetë, madje kështu këpuca ka jetë më të gjatë.

Pse kjo zgjedhje?
 Menduam që nëse donim të kishim një produkt të ri për një



treg të ri, produkti duhet të ishte sa më novator, edhe në prodhim, ndaj zgjodhëm të sfidonim tregun edhe në këtë mënyrë.

Ku e shihni veten në të ardhmen?

Në të ardhmen e afërt dëshirojmë të shohim këpucët tona në të gjitha dyqanet e Italisë

dhe më pas të hapim një dyqan on-line të këpucëve tona e pse jo të hapim zgjerohemi në Europë. Tani për tani po mjaftohemi me Italinë.

Ndonjë këshillë për ndonjë që, si ti, dëshiron t'i hyjë rrugës së sipërmarrjes private?

Do të kisha një dy: të shfrytëzojnë sa më mirë pasionet e veta, sepse - nëse janë pasione të vërteta - asnjë nuk mund t'i njohë më mirë se ai që i ka dhe janë një shtysë energjike e pabesueshme. E dyta ka të bëjë me gjuhët: njohja e tyre është e domosdoshme: nuk kam mbaruar universitetin sepse nuk më pëlqente por gjithnjë kam kultivuar gjuhët e huaja dhe sot flas shtatë gjuhë, të gjitha mirë apo shumë mirë.

Fjorick, është emri i firmës, ka të bëjnë me emrin tënd?

Është bashkimi i emrit tim me atë të Ricardos (shkurt Ricky). Mendova që një biznes i lindur nga një pasion i madh duhet të kishite diçka romantike, qoftë edhe në emër.

Liliana Bossi, Il Sole 24 ore

SuperEnalotto

SuperEnalotto është një lojë e thjeshtë dhe zbatimëse e bazuar në numra. Mund të luash çdo ditë jave dhe rezultatet jepen çdo të martë, të enjte dhe të shtunë. Cila do të jetë dita jote me fat?

Është kollaj të luash dhe është e lehtë të fitosh!

A e dije se të luash dhe të fitosh në SuperEnalotto është tepër e thjeshtë? Zgjidh 6 numra nga 1 deri në 90 dhe gjej cilët do të jenë numrat me fat. Zgjidh numrat që ke dëshirë të luash në dy panelet që gjenden në skedinë: ke 5 mundësi të mira për të fituar, duke gjetur 6, 5 + numrin zhol (jolly), 5, 4 ose 3 numra të nxjerrë. Mund të fitosh shpesh: çdo javë ka tre konkurse për të trefishuar zbatimin tënde. Luaj të paktën 1 euro, dhe do të kesh mundësi të fitosh shumë më tepër!

SuperStar dhe Giocata Magica: shumëfishoje fatin!

Por nuk mbaron me kaq. Vetëm me 0,50 euro më shumë mund të zgjedhësh variantin SuperStar dhe të zbatimësh akoma më shumë. Në qoftë se gjen numrin SuperStar, i cili del automatikisht në momentin e luajtjes, i shumëfishon fitoret tuaja me 6, 5, 4 ose 3 numrat e nxjerrë që ke gjetur, por jo vetëm kaq: mund të fitosh edhe me 2, 1 ose 0! Loja minimale SuperEnalotto është gjithmonë 1 euro, dhe mund të vendosësh të çiftosh SuperStar me njërin ose me të dy panelet e lojës. Dhe me Giocata Magica, zgjedh një pjesë loje me 1, 2, 5 ose 10 euro: terminali në lokalet e lotarisë (ricevitoria) do të zgjedhë për ty kombinimin e rastësishëm e të 6 numrave me fat, të çiftuar me SuperStar.

Mos humb asnjë rast për të fituar!

Çdo hedhje në short mund të jetë ajo që duhet. Në qoftë se zgjedh Abonimet mund ta përsëritësh lojën për 2, 3, 4, 5, 6, 9 konkurse (3 javë), 12 konkurse (4 javë) ose 15 konkurse (5 javë). Dhe me Sistemet, ke tipologji të ndryshme lojërash ndërmjet Sistemeve të Reduktuar e Bazë dhe Variante: shumë kombinacione dhe shumë mundësi për të vazhduar të zbatimësh!

A i ke zgjedhur numrat e tu me fat?

Mos prit më! Mendo numrat që për ty kanë një kuptim të veçantë: për shembull, numrat me fat sipas traditës së vendit tënd. Ose një datë të rëndësishme, ditëlindjen e një personi të dashur, një ëndërr. Zbavit duke zgjedhur kombinimet për të luajtur: mund të jenë numrat e saktë për të fituar! Dhe në qoftë se blen kuponët me kombinimet e prodhuara automatikisht në momentin e lojës në lokalit të lotarisë (ricevitoria), do të zbatimësh akoma më shumë: duhet vetëm të vendosësh shumën që do të luash dhe të provosh emocione duke e lënë veten krejtësisht në dorë të fatit!

Blej menjëherë një lojë: gjej SuperEnalotto në të gjitha lokalet e lotarisë (ricevitorie) Sisal.

Sisal nuk është vetëm një ndërmarrje që organizon lojërat por edhe një rrjet shërbimesh për qytetarët me një ofertë komplekse dhe të artikuluar e cila sot përbëhet nga rreth 230 shërbime aktive. Shumë nga këto shërbime janë futur në rrjetin tonë të lokaleve të lotarisë (ricevitorie) për t'ju përgjigjur më mirë kërkesave e të huajve në Itali, ndërmjet të cilave: rimbushjet për telefoninë e lëvizshme (celularët), kartat telefonike ndërkombëtare me garanci dhe leverdi më të madhe, shërbimin e transfertës së parave (money transfer) për transferimin e parave në kohë reale në të gjithë botën dhe dërgimin e zarfeve dhe të pakove për të gjitha destinacionet në Itali dhe jashtë shtetit.

Luaj sot. Bëhu milioner.

Luaj me përgjegjësi.

**FORLI: JUVENILJA DHE SPARTITI PER SCUTARI NË FESTËN E POPUJVE NË FORLI**

Edhe këtë vit, Qendra për paqen "Annalena Tonelli" në Forli ka organizuar Festën e Popujve në bashkëpunim me shoqatat që e mbështesin dhe komunitetet e të huajve në qytet.

Mbrëmja kushtuar Shqipërisë, 11 shtatori, pati një sukses të merituar, falë organizimit të bërë nga të rinjtë e shoqatës Juvenilja. Ata sollën jo vetëm imazhe të Shqipërisë e pjata tipike të kuzhinës sonë, si qofte, byrek, bakllava, hallvë etj, por edhe grupin tashmë të famshëm "Spartiti per Scutari" të drejtuar me mjeshtri nga Bardh Jakova. Spektakli i dhënë nga orkestra, këngët e vallet e marra nga artistët mbi skenë por edhe nga publiku gjallëruan mbrëmjen duke e kthyer atë në një festë të vërtetë jo vetëm për shqiptarët e pranishëm por edhe për vendasit e dëfryer pamasë.



SuperEnalotto

**Është më kollaj të fitosh
në SuperEnalotto se sa
të lindësh me fat.**



Fati është njësoj për të gjithë.
Mjafton të luash SuperEnalotto,
çdo të martë, të enjte e të shtunë.
Mos prit më, kërkoje fatin tënd në të gjitha
lokalet Sisal (ricevitoria) ku luhet lotaria.

Luaj sot. Bëhu milioner.



Luaj me përgjegjësi.

Një ekspozitë në muzeun hebraik Carlo e Vera Wagner të Triestes

HISTORITË e shqiptarëve që mbrojtën hebrenjtë mbërrijnë në Itali

Pse im atë shpëtoi një të panjohur duke vënë në rrezik jetën dhe gjithë fshatin? Im atë ishte mysliman i devotshëm: besonte se të shpëtojë një jetë do të thoshte të shkoje në parajsë".

I panjohuri që babai i Enver Pashkajt arriti të shpëtonte ishte një hebre me emrin Yehoshua Baruchowicz, një zotëri, sot në moshë të thyer, dentist në Meksikë.

Jemi në Pukë, vend i vogël majë maleve shqiptare, gjatë viteve të luftës së dytë botërore kur Ali Sheqer Pashkaj, pronar i të vetmit dyqan të zonës, ndien keqardhje për një të burgosur të ri që po çohet drejt vdekjes së sigurt nga një autokolonë gjermane. Me një zgjuarsi të rrallë e aftësi reaguese të menjëherëshme u ofron për të pirë rojeve deri sa dehen dhe ndërkohë organizon arratisjen e Yehoshuas në pyll. Kur e zbulojnë nuk rrëfen ("katër herë i vunë revolen në ballë. U kthyen dhe kërcënuan se do t'i vinin zjarrin gjithë fshatin nëse im atë nuk rrëfente"). Dhe kur nazistët largohen shkon dhe gjen djalin në pyll dhe e mban të fshehur në shtëpi të vet deri në përfundim të luftës.

Pak vjet më parë Ali Sheqer Pashkaj është nderuar nga Yad Vashem, muzeu i Holokaustit në Jerusalem, me titullin "I drejti i kombeve", titull që u jepet të gjithë atyre që gjatë viteve të persekutimeve raciale rrezikuan jetën për të shpëtuar hebrenj. Ky

i tiji nuk është ama rast i izoluar por simbol i qëndresës të guximshme që bënë shqiptarët gjatë luftës, për të mbrojtur dhe shpëtuar rreth 2 mijë hebrenjtë në emër të Besës, kodit të lashtë të nderit të rrënjësuar thellë në kulturën e traditën e tyre.

Kjo histori e jashtëzakonshme, deri më sot e panjohur nga opinioni publik perëndimor, është rindërtuar në ekspozitën "Besa, një kod nderi. Shqiptarë myslimanë që shpëtuan hebrenjtë nga Shoah" për të parën herë në versionin italian në muzeun hebraik Carlo e Vera Wagner të Triestes. Për domethënien e thellë historike dhe për vlerën e saj etike, ekspozita "Besa" ishte edhe pjesë integruese e Ditës europiane të kulturës hebraike që të dielën më 6 shtator pati në Trieste një sërë eventimesh dedikuar mikpritjes dhe dialogut mes popujve. E realizuar nga muzeu Yad Vashem, ekspozita përbëhet nga një sërë imazhesh të fotografit amerikan Norman Gershman, që për sepse vjet ka përshkuar gjerë e gjatë Shqipërinë duke rikuperuar dëshmitë e këtyre akteve të mrekullueshme dhe duke i dokumentuar ato përmes portreteve të shpëtimtarëve apo të pasardhësve të tyre.

Portretet në bardhezi të këtj nxënësi të Ansel Adams-it, Roman Vishniac-ut dhe Arnold Newman, shoqërohen nga intervista të shkurtra që dëshmojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë lëvizjen kapilare popullore, të frymëzuar më shumë nga një frymë e fortë devotshmërie dhe



Në guximin absurd të Liza Pilkut që u grind me fjalë me agjentët e Gestapos për të mos i lënë t'i bastisnin shtëpinë ku mbante fshehur tre hebrenj nga Hamburgu apo i Ismail Meçes që nuk hezitoi të ruante shtëpinë e tij në fshat me armë në dorë për të mbajtur larg spiunë e nazistë



solidariteti njerëzor sesa nga motive të tipit politik dhe kulturor.

Pikëpyetjet e intervistuesit (pse e keni bërë, ç'ju shtyu të rrezikonit jetën, si ia dolët nën hundën e okupatorëve) gjejnë përgjigje të drejta e të thjeshta që të mallëngjejnë. Ai që vepron në respekt të kodit të Besës, - shpjegojnë protagonistët, - është njeri që mban fjalën e dhënë, të cilit mund t'i besosh edhe jetën tënde dhe të familjes.

"Nuk ka të huaj në Shqipëri, ka vetëm miq - tregon Drita Veseli, një nga gratë e intervistuarra. - kodi moral i shqiptarëve e kërkon të jemi mikpritës me mikun në shtëpinë apo në fshatin tonë".

"Shtëpia jonë - vazhdon - është para së gjithash shtëpi e Zotit, pastaj e mikut e së fundi edhe shtëpi e familjes sonë. Kurani na mëson që të gjithë njerëzit, hebrenj, të krishterë, myslimanë jetojnë nën të njëjtin Zot".

"Të ndihmojmë njëri tjetrin është detyrim moral - thotë Adile Kasapi. - Besimi ynë fetar ishte pjesë e edukimit tonë familjar. Ishte e paimagjinueshme të padisje hebrenjtë në nevojë".

"Si myslimanë të devotshëm shtrimë mbrojtjen dhe humanitetin tonë edhe për hebrenjtë. Pse? Besa, miqësia dhe Kurani i shenjtë" sintetizon Beqir Qoqia.

"Besa - shpjegon fotografi Norman Gershman, - është më shumë se mikpritja. Është një ndjenjë që të lidh me atë që të hyn në shtëpi, në sferën tënde private, kundër çdo armiku e fatkeqësie. Familjet myslimane - tregon fotografi - më përsëritnin

EKSPOZITA

"BESA, UN CODICE D'ONORE. ALBANESI MUSULMANI CHE SALVARONO GLI EBREI DALLA SHOAH" MUND TË VIZITOHET DERI MË 15 TETOR NË MUSEO EBRAICO CARLO E VERA WAGNER VIA DEL MONTE 7, TRIESTE

ORARI: E HËNË, E MËRKURË, E ENJTE, E PREMTE, E DIEL ORA 10.00-13.00; TË MARTË 16.00-19.00



vazhdimisht që të shpëtosh një jetë njeriu do të thotë të shkosh në parajsë. Bijtë e një shpëtimtari më thanë që parimi që u kish mësuar i ati, sipas të cilit jetojnë, është "nëse dikush troket në portën tënde, duhet të marrësh mbi shpatulla përgjegjësinë". Marrja e përgjegjësisë mbi shpatulla e shqiptarëve u përkthye në raste shpëtimi gjithë peripeci, si në atë të Ali Sheqer Pashkajt. Në bujarinë e familjes Kasapi, që për mëse dy vjet në Tiranë bashkëjetoi në dy dhoma me pesë familjarët e Moses Frances-it duke u përballur me kërcënime e rrahje. Në vetëmohimin e Eshref Shpuzës që i siguroi pasaporta të falsifikuara të gjithë familjes Abravanel e me pas i shoqëroi, tre të rritur e dy fëmijë, deri në kufi me Jugosllavinë, e për të cilët mësoi se arratia kish qenë e suksesshme vetëm vite pas luftës (sot familja Abravanel jeton në Izrael).

Në guximin absurd të Liza Pilkut që hëngër me fjalë me agjentët e Gestapos për të mos i lënë t'i bastisnin shtëpinë ku mbante fshehur tre hebrej nga Hamburgu apo i Ismail Meçes që nuk hezitoi të ruante shtëpinë e tij në fshat me armë në dorë për të mbajtur larg spiunë e nazistë.

Janë gjeeste që marrin akoma më shumë kuptim po të shohim jetët e shpëtuar. Gjatë dhjetëvjeçarëve të parë të shekullit XX Shqipëria, kryesisht myslimane, numëronte vetëm 200 hebrej në një popullsi prej 803 mijë banorësh. Pas ardhjes në pushtet të Hitlerit në Shqipëri u

Pas ardhjes në pushtet të Hitlerit, në Shqipëri u fshehën nga 600 deri në 800 hebrej nga Gjermania, Austria, Serbia, Jugosllavia dhe Greqia, me shpresën se nga andej mund të imbarkoheshin për në Izrael apo Amerikë. Shqipëria i mirëpriti dhe pas pushtimit nazist në vitin 1943 refuzoi të dorëzonte listat e hebrejve që jetonin në vend.



fshehën nga 600 deri në 800 hebrej nga Gjermania, Austria, Serbia, Jugosllavia dhe Greqia, me shpresën se nga andej mund të imbarkoheshin për në Izrael apo Amerikë.

Shqipëria i mirëpriti dhe pas pushtimit nazist në vitin 1943 refuzoi të dorëzonte listat e hebrejve që jetonin asokohe në vend. Agjenci të ndryshme qeveritare u siguruan hebrejve dokumente të rreme që u lejuan të përziheshin me pjesën tjetër të popullsisë. Kështu, ashtu si populli edhe klasa politike, së bashku, arritën të shpëtonin mijëra jetë fëmijësh, grash e burrash.

Kodi i lashtë i nderit, që sipas interpretimit të shqiptarëve lind nga besimi mysliman, u përje me nderin kombëtar dhe frymën humanitare. Dhe për të mbajtur Besën, popullsia shqiptare myslimane vuri në rrezik edhe jetën e vet duke u ofruar strehim, veshmbathje, ushqim dhe miqësi të sinqertë që në në shumicën dërrmuese të rasteve vazhdon edhe sot e kësaj dite e lidh edhe pasardhësit në një shkëmbim të shpeshtë vizitash dhe letrash.

Rezultati që që të gjithë hebrejtë ë ndodheshin brenda kufijve të Shqipërisë gjatë pushtimit gjerman u shpëtuan, me përjashtim të shumë pak familjeve. Shqipëria, i vetmi vend evropian me shumicë myslimane ia doli mbanë një veprë madhështore me të cilën shumë kombe europiane dështuan. Fjalët e këtyre shpëtimtarëve, të gjithë të nderuar me titullin "Të drejtët e kombeve", janë këtu - që të pasionojnë se roman - për të na kujtuar që shkruajnë dalimin në histori jo vetëm banaliteti i të keqes por edhe përditshmëria e një guximi kaq të sigurt në arsyet e tij. Në të njëjtën kohë ky rrëfim koral arrin, me vërtetësinë e tij, për të vënë në diskutim e për të hedhur poshtë paragjykimin e sotëm të dyfishtë. Atë mbi myslimanët, që shpesh shihen nën dritën e vetme të vagëlluar dhe verbuese të fundamentalizmit dhe të antisemitizmit. Dhe atë mbi popullin shqiptar, që kaq shpesh gjatë viteve të fundit i është treguar me gisht opinionit publik si i rrezikshëm apo i prirë për të të bërë keq. Për të dyja rastet ia vlen të citohen vëllezërit Refik dhe Hamid Veseli sipas të cilëve: "kushdo të të trokasë në derë është bekim i Zotit: të gjithë personat vijnë nga Zoti".

Daniela Gross

Ishte komandant i artilerisë kundërajrore shqiptare. Në shkollën e mesme ushtarake të Durrësit, me 20 vjet karrierë dhe 300 burra nën komandë. Fillimisht nën regjimin komunist të Enver Hoxhës, më pas nën demokratikun Sali Berisha. Por ai gjithnjë kaluar, mbi kodrat e thepisura të Beratit. Një detyrë shumë e kërkuar dhe me pushtet gjatë viteve nëntëdhjetë. Më pas pensioni i parakohshëm dhe zgjedhja e ardhjes në Itali për të jetuar pranë disa të afërmeve.

Dhe ja sot, kapiteni Doda, komandanti i Beratit: në zonën e shërbimeve San Pelagio Est, parkingu i autogrillit.

Ramiz Doda është 56 vjeç, burrë i fisëm, me flokë të shkurtër, syze, këmishë borë të pastër. Nuk bën karburant, nuk hyn në bar. Vetëm shkon e merr një leckë, e lag dhe fillon të pastrojë xhamat e një viture Fiesta që sapo u parkua. Tamam kështu, komandanti Doda sot është larës i xhamave të makinave në autostradë. "Fatkeqësisht" thotë duke hapur krahët dhe me një buzëqeshje që nënkupton "S'kam ç'bëj". Nuk dëshiron të tregojë historinë e tij, është çështje dinjiteti, sipas tij, por më në fund e bindëm.

E atëherë, del në dritë rrëfimi i një njeriu që ka jetuar dy botë të ndryshme, shumë larg njëra tjetrës, Pallatin dhe Rrugën, Komandën dhe Përruljen, Rregullin dhe Kaosin.

Ishte dikush-i, njëherë e një kohë, kapiten Doda, por sot është askush-i.

"Eh, atje më hapnin derën e më vinin nga pas - thotë duke qeshur - Këtu është gjithçka ndryshe, jam unë ai që duhet t'u vrapoj nga pas të tjerëve". Larësi i xhamave Ramiz Doda është jashtëzakonisht i sjellshëm dhe elegant. Nuk i kërkon asgjë askujt. Por përdor një hile: lë xhamafshirëset të ngritura në mënyrë që njerëzit të kujtohen për të. "Nëse duan të më japin diçka mirë, nëse nuk duan, s'ka gjë". Punon 4-5 orë në ditë, fiton nga 20 deri në 40 euro, fitime që varen nga trafiku, koha, humori, fati. Pastaj kthehet në shtëpinë e tij në Casalserrugo, të provincës së Padovës, dhe pret të nesërmen.

Shkuam t'i bëjmë vizitë në këtë apartament të vogël të periferisë. Na e hapi derën e shoqja, Majlinda një zonjë e ëmbël dhe e heshur. U ngjan bashkëshorteve të gjeneralëve, të mësuar me respektin e thellë për mysafirin. Të tregon vendin për t'u ulur, përgatit tabakanë me ëmbëlsirë dhe diçka për të pirë, dhe ulët në një qosh e gatshme për t'u ngritur menjëherë në rast nevojë: fotografi, dokumente, kujtime. Shtëpia vjen

Metamorfoza e dhimbshme e Ramiz Dodës

Ishte komandant i artilerisë kundërajrore shqiptare. Në shkollën e mesme ushtarake të Durrësit, me 20 vjet karrierë dhe 300 burra nën komandë.

Dhe ja sot, kapiteni Doda, komandanti i Beratit: në zonën e shërbimeve San Pelagio Est, Padova. Është 56 vjeç, burrë i fisëm, me flokë të shkurtër, syze, këmishë borë të pastër. Nuk bën karburant, nuk hyn në bar. Komandanti Doda sot është larës i xhamave të makinave në autostradë. "Fatkeqësisht" thotë duke hapur krahët dhe me një buzëqeshje që nënkupton "S'kam ç'bëj".

erë shumë të mirë, gjithçka është në vendin e vet, plot me të shkuarën e atyre që e banojnë. Një foto e tij kur ishte i ri, me uniformën e ushtarakut. Një tjetër mbi kodrat e Durrësit, gjithnjë ai, gjithnjë me uniformë. "Nuk ka një jetë sepse regjimi komunist i kish hequr. Me Enver Hoxhën s'kishte grada. Unë kam studiuar si ushtarak, kam komanduar kompani dhe batalione, por nuk isha as kapiten e as gjeneral. Jam bërë vetëm pas rënies së regjimit". Nuk ka luftuar asnjëherë sepse gjatë viteve kur kishte komandën Shqipëria ishte në paqe. "por shtihet me armë sidoqoftë. Duhet të ishim gati për t'u përballur me armikun e mundshëm".

Karriera e tij i ka ngjarë pak asaj të raketave që hidhte, e shpejtë dhe vertikale.

Tridhjetë, njëqind, treqind burra. Në moshën 35-vjeçare ishte një nga njerëzit më shkëlqyeshëm të Mbretërisë së Tiranës. "Ishin vite krejt ndryshe nga sot, edhe për Shqipërinë. Nuk kishte nevojë për para, sepse ishim pak a shumë të gjithë njësoj nga ajo pikëpamje. Pak për të gjithë. Ekzistonin disa dallime por ishin më shumë në rang statusi sesa ekonomike. Unë komandoja dhe njerëzit më respektin. Por shtëpia ku jetoja nuk ishte e imja, por e shtetit. Makina nuk ishte e imja, por e ushtarisë. Më kuptoni?"

Gjithçka ndryshoi me rënien e regjimit në vitin 1991. "Mbeta komandant dhe më dhanë menjëherë gradën e kapitenit, e kapitenit të parë. Por më pas bënë reformat dhe filluan t'i nxjerrin të gjithë ushtarakët në pension. Mes tyre, edhe unë. Njëqind euro në muaj, pak a shumë". 40 vjeç kishte një jetë përpara, televizioni filloi

të jepte imazhe nga Perëndimi, nga Italia e bukur dhe e begatë, vetëm pak orë larg me gomone. "Disa të afërm ishin larguar ndërkohë, kështu vendosa të vij edhe unë këtej". Si? "Me të vetmin mjet që kishim atëherë në dispozicion: gomonen. U nisa nga Vlora dhe zbarkova në Otranto".

Pagoi një skafist, 250 euro, udhëtoi tërë natën, fjeti në një shtëpi të braktisur në fushat leçeze dhe më në fund arriti te i vëllai në Frosinone, Anagni. Iu fut punëve ga më të ndryshmet por nuk zgjati shumë: pesë muaj. "Ime shoqe kish mbetur në Berat me fëmijët, mendova të kthehem pasi e pashë që Italia nuk ishte parajsja që më kishin përshkruar". E kështu u kthye. Por edhe Shqipëria nuk ishte më si përpara. "Njerëzit po varfëroheshin, ndërsa pasuria përfundonte në duar të të njëjtëve pak persona. Kështu edhe djali im Eduardi erdhi në Itali, edhe ai me një skafist".

Komandanti Doda ishte në mëdyshje: familja e ndarë, Shqipëria e tronditur nga ekonomia e tregut, zemra këtej e ëndrrat andej. "Më në fund vendose të vij te im bir në Padova, këtë radhë si i rregullt, falë bashkimit familjar".

Biletë, anije, leje qëndrimi. Komandanti Doda i ka bashkuar të gjithë në Padova: tre bijtë dhe gruan. Krenaria e tij është vajza: "Studion arkitekturë në Venecia". Ai vetë, tashmë me flokë të thinjur në një vend ku nuk ka ndonjë avion që duhet hedhur poshtë, i është nënshtruar fatit. Prej katër vjetësh punon në autostradë, si larës xhamash. Nostalgji për regjimin e vjetër? "Jo, absolutisht jo. Ishim tepër të izoluar dhe të varfër. Enver Hoxha gaboi me të gjitha". I lumtur me Berishën? "As me të, jo. Më shkatërroi jetën. Në Shqipëri jetohej më keq se më parë. Duhet të ketë një vijë të mesme". Berlusconi? "Kohët e fundit më ka pëlqyer shumë sepse ka treguar se di të veprojë. U dha shtëpitë të dëmtuarve nga tërmeti". Po a nuk është tepër i pasur? "Por nëse nuk je i pasur nuk bën asgjë". Kështu i duket Dodës.

Një lutje të fundit: a mund ta bëjmë një foto me leckën e pastrimit? "Joo, ... më shohin njerëzit". E ka të drejtë, në Shqipëri është akoma Komandant Doda.

Andrea Pasqualetto, Corriere del Veneto



ISTITUTO LUCE
PRESENTA



ALBANIA

IL PAESE DI FRONTE

REGIA
ROLAND SEJKO
MAURO BRESCIA



LUCE

**IL PRIMO DOCUMENTARIO
SULLA STORIA DELL'ALBANIA**



REGIONE LAZIO

N E L L E M I G L I O R I L I B R E R I E

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
15								16					
		17			18	19		20		21			
22				23		24		25	26		27		
		28			29			30		31			
		32			33		34						35
36	37			38						39	40		
			41	42			43			44			
45			46			47		48		49			
50			51				52		53				
54							55						

HORIZONTALISHT

1. Veshje çeliku për luftëtarët e lashtë. 8. Butak deti. 15. Poezi lirike me përmbajtje të përvajshme. 16. Shtet i Greqisë së lashtë me Agamemnonin mbret. 17. Krahë pa çifte. 18. Sipas popullit kur i ke flori, dmth se je i zoti për çdo punë. 21. Pjesëtar i një grupi popujsh me gjuhë indoevropiane që banojnë kryesisht në Europën Lindore. 22. Rrethi i hekurt ku mbahet, kapet diçka. 24. Njëra nga shenjat e pikësimit. 27. Britma që dëgjohej në arenë. 28. Lloj fizikulture. 30. Ngelen pasi siset mielli. 32. Mjete Mësimi Autodidakte. 33. Përfaqësues diplomatik i shtetit në një shtet tjetër. 36. Imja e latinëve. 38. Ushtron një sport dimëror. 39. Gardner e kinemasë. 41. Jo bosh. 43. Sipas popullit, kur të bëher gjaku ashtu ngjyre, dmth se trembesh, frikësohësh shumë. 44. Mbyll të gjitha lutjet. 45. Hyka i "Përsëri në këmbë". 46. Lëndë organike që përmban azot. 48. Anti Marksiste. 49. Françesk i këngës shqiptare. 50. Përemër i gjuhës angleze. 51. Përbindëshi si gjarpër me shumë kokë që, sipas mitologjisë, rriteshin sa herë i prisje/ Kafshë jovertebre 53. Bashkatdhetar dhe bashkëkohor i Ciceronit. 54. Falas. 55. Gdhend.

VERTIKALISHT

1. Mënyrë si zihet peshku. 2. Pacino i kinemasë. 3. Synon të risisë shitjet. 4. Shpend uji. 5. Sipas popullit, kur po të digjet, dmth se je në hall të madh. 6. Tomi pa teke. 7. Tërësia e vetive që fitohen në ndikimin e familjes, etj. 8. Marks i "Kapitalit". 9. Lëndë Mësimi. 10. Lidhja Islamike. 11. Bosht. 12. Janë veprat dramatike ku tragjikja gërshetohet me komiken. 13. Historikë të një fushe të veprimtarisë së një organizate. 14. Vija që lë pas diçka; gjurma. 19. Shtet në SHBA. 20. Vendosa de-tyrimin që i paguhet shtetit. 23. Akademi Orientale. 25. Shkëlqim a dritë në ngjyrë si të arit. 26. Markë makine. 29. Mikrobe. 31. Një rrokje e Nolit. 34. Premër vetor i shqipes. 35. Qyteti në veriperëndim të Greqisë. 37. Pjesë më e privilegjuar e një shtrese shoqërore. 38. I madhi Alberto i kinemasë Italiane. 40. Princ austriak që mbretëroi në Shqipëri. 42. Mes Jorge e Borges. 44. Lumë në Azinë Jugperëndimore që rrjedh në Lindje të Turqisë dhe përgjatë kufirit veriperëndimor të Iranit, Armenisë e Azerbajhanit. 45. Figurë e përrallave popullore shqiptare. 47. Pohim gjer-man. 51. Hotel Europa. 52. Largohu; nisu. 53. Meli pa një rrokje.

VERTIKALISHT: 1. PESHKIM. 2. AL. 3. REKLA-
MA. 4. ZGJALEM. 5. MUEKRA. 6. OI. 7. EDUKIM. 8.
KARL. 9. LM. 10. LI. 11. AKS. 12. MELODRAMAT
VA. 23. AO. 25. PPARIM. 26. AUDI. 29. BAKTERE
31. NO. 34. ATA. 35. JANINA. 37. ELITE. 38. SOR
DI. 40. VIDI. 42. LUIS. 44. ARAS. 45. DIV. 47. JA
51. HE. 52. IK. 53. LI.

HORIZONTALISHT: 1. PARZMORE. 8. KALLA-
MAR. 15. ELEGJI. 16. MIKINA. 17. KAE. 18.
DUART. 21. SLAV. 22. HALKA. 24. KLLAPA. 27.
AMBASADOR. 36. MEA. 38. SKIATORI. 39. AVA
JA. 48. AM. 49. RADI. 50. IT. 51. HIDRA. 53. LATIN.
41. PLOT. 43. MAVI. 44. ANIN. 45. DIN. 46. URE-
54. VERESIE. 55. SKALIS.

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
15									16		17	18	
19					20			21			22	23	
24			25	26		27		28			29		
30					31		32						33
34			35			36			37				
		38						39			40	41	42
	43						44	45			46		
47			48			49				50			
51					52					53			54
55					56					57			

HORIZONTALISHT

1. Kryqëzimi për të përmirësuar racen. 9. Popa pa çifte. 12. Mëlyshi, dëshmor. 15. Janë prodhuesit më të mëdhenj të energjisë elektrike në Shqipëri. 18. Jo për Maldinin. 19. Tase e voleybollit. 20. Organizatë terroriste baske. 21. Përshëndetje spanjolle. 22. Bator i Mongolisë. 24. Stafa I "Qortimet e vjeshtës. 27. Rruga që përshkohet drejt një destinacioni. 30. Një lloj alkooli. 32. Njeri jo i ngurtë, jo i prerë. 33. Sundimi Otoman. 34. Notë muzikore. 35. Ai që duket nuk do kallauz... 37. Mbyllin belatë. 38. Nënë në latinisht. 39. Pozicion luftimi; llogore. 43. Figurë gjeometrike. 44. Zhyl i "Kapiteni pesëmbëdhjetë vjeçar". 46. Memoria operative e kompjuterit. 47. Kryeqyteti i Oregonit në SHBA. 49. Ishte për jetën në një roman të Irving Stone. 50. Hidrocentral mbi Drin. 51. Ai i individit u dënua në një kongres të PPSH-së. 52. Anti Luftarake. 53. Moss i telenovelës "Beautiful". 54. Toga pa çifte. 55. Jo plak. 56. Faik i letrave shqiptare. 57. Gadishull në Ukrainë, në Detin e Zi.

VERTIKALISHT

1. Thonë se je top i tillë, kur je e shëndetshme dhe e bukur. 2. Dredhite; dinakëritë. 3. Ishte burri i parë. 4. Rërë pa çifte. 5. Stop pa lllimite. 6. Akull në Londër. 7. Bega I humorit (i shq.). 8. Zemërimet; pakënaqësitë kundrejt dikujt. 9. Pasuria që i përket dikujt. 10. Shteti në jugperëndim të Azisë. 11. Mbret italisht. 13. Karenina e Tolstojit. 14. Bardhyl, poet. 16. Titull me të cilin i drejtohen princërve. 17. Nga Stambolli. 23. Lëndë Inorganike. 25. Fillon me shkronjën A. 26. Franc, pianist i madh. 28. Shqiptarët e lashtë. 29. Përemër vetor. 31. Komisioni Historik European. 33. Grindje a zënkë shumë e zhurmshme. 36. Flori. 38. Mund të jetë dhe me erë. 40. Është e fatit atëhere kur ndodh diçka që nuk pritej, e as që mendohej. 41. Posedoj. 42. Arben, qendërsulmues i kombëtares në '80. 43. Quajnë turqit një të krishterë. 44. Rada aktor i estradës. 45. Roje pa çifte. 47. I vesh kush ecën në borë. 48. Sipas popullit, është mirë se një çiflig. 50. Njerëz që këndojnë së bashku. 52. Nyje e pashqar në anglisht. 53. Froku pa teke.

VERTIKALISHT: 1. SHEGJERI. 2. HILETE. 3. ADA-
MI. 4. RR. 5. TO. 6. ICE. 7. METI. 8. INATET. 9.
PRONA. 10. PALESTINA. 11. RE. 13. ANA. 14.
LONDO. 16. LARTESI. 17. TURK. 23. LI. 25. ALFA-
BET. 26. LIST. 28. ILIRET. 29. AI. 31. KHE. 33.
SHAMATE. 36. AR. 38. MULLI. 40. IRONI. 41.
KAM. 42. MINGA. 43. KAUR. 44. VELLI. 45. RJ. 47.
SKI. 48. MIK. 50. KOR. 52. AN. 53. RK.

HORIZONTALISHT: 1. SHARTIM. 9. PP. 12. PAL-
15. HIDROCENTRALLET. 18. NO. 19. ELA. 20. EJA.
21. OLA. 22. ULANI. 24. OSMAL. 27. ITINERARI.
FISHATI. 37. TE. 38. MATER. 39. ISTIKAM. 43.
KUB. 44. VERINI. 46. RAMI. 47. SALEMI. 49. EJA.
50. KOMANI. 51. KULTI. 52. AL. 53. RON. 54. TG.

www.stranieriinitalia.it

Faqet internet të emigracionit

Çdo ditë lajme, hulumtime dhe informacione të dobishme për të gjithë të huajt në Itali.

Stranieri in Italia



Dashi (21 mars - 20 prill)

Me nxitjen e yjeve mund të ndërmerrni aksione të guximshme por të projektuara me kujdes, sidomos në fushën profesionale. Në dashuri, mos u mundoni të ndryshoni asgjë, është çasti të tërhiqeni dhe të analizoni çfarë dëshironi vërtet nga jeta e çiftit, pa humbur kohë dhe para.



Demi (21 prill - 20 maj)

Mbështetja e yjeve nuk ju mungon për të përfunduar një detyrë delikate por jo shumë të vështirë. Gjeni një çast për të analizuar nevojat tuaja, që kohët e fundit kanë ndryshuar. Në dashuri, mund të mbani të ndezur marrëdhënien tuaj me pak zemërgjerësi që do të vlerësohet shumë nga partneri.



Binjakët (21 maj - 21 qershor)

Janë të shumtë planetët që ju përkrahin, e megjithatë nuk do të bëni hapa të rëndësishëm përpara. Duhet t'u përshtatni projektet tuaja situatave të reja. Në dashuri mundohuni të vini pak rregull në idetë tuaja; më pas do të keni të reja shumë interesante që mund t'ju ndryshojnë rrjedhën e jetës.



Gaforja (22 qershor - 22 korrik)

Vazhdon ndikimi pozitiv i Jupiterit ndaj shenjës tuaj, por kundërvënja e Marsit nuk ju lë të përfundoni as edhe detyrat më të thjeshta. Dashuria mund t'ju japë shumë kënaqësi nëse do të tregoheni më tolerantë me partnerin e do të përipiqeni ta kuptoni pa filluar grindje të kota pa fund.



Luani (23 korrik - 23 gusht)

Vazhdojnë stimujt pozitivë të Neptunit dhe Uranit që sugjerojnë meditim të thellë e ndonjë ndryshim në jetën e përditshme. Nëse dëshironi më shumë nga dashuria, duhet t'i tregoni partnerit se jeni të gatshëm të sakrifikoni gjithçka për të. Kujdesuni më shumë për pamjen tuaj të jashtme.



Virgjëresha (24 gusht - 22 shtator)

Venusi vazhdon të jetë dashamirës me shenjën tuaj: gjallëron jetën familjare, shoqërinë dhe ju mban në humor. Do të dini të kapërceni me fjalë të ngrohta çdo keqkuptim që mund të lindë në dashuri. Në punë e çështjet financiare duhet të tregoheni të kujdesshëm për të mos rënë në krizë.



Peshorja (23 shtator - 22 tetor)

Dashuria do të jetë plot lëvizje por shumë i rëndësishëm për ju. Për punën mund të keni të reja pozitive, rreth datës 20, ndërsa investimet do t'ju japin rezultate të shkëlqyera. Me shëndetin gjithçka në rregull, të vetmet këshilla: të hani me masë dhe të zhvilloni pak aktivitet fizik.



Akrepi (23 tetor - 22 nëntor)

Jeni ende në mëdyshje mbi çështje që kanë të bëjnë me seksin e dashurinë. Duhet të tregoheni pak të duruar, shumë shpejt do të keni elementë të rinj mbi të cilët mund të merrni një vendim të prerë. Në punë mbani sytë hapur, për të mos u gjetur në vështirësi të pakapërcyeshme.



Shigjetari (23 nëntor - 21 dhjetor)

Vazhdon një situatë e qetë pa asgjë për t'u shënuar. Mund të shfrytëzoni këtë çast për të analizuar ngjarjet e fundit duke qenë sa më objektivë e duke i bërë të qarta gabimet vetvetes. as në dashuri nuk do të keni të reja të ndjeshme, mundohuni të jeni më optimistë e të shihni anët pozitive të jetës.



Bricjapi (22 dhjetor - 20 janar)

Marsi nxit rendimentin tuaj në punë dhe ju bën gjithnjë e më të ndërgjegjshëm për përgjegjësitë që mbani mbi shpatulla. Në dashuri nuk është fushë me lule, mund të përmirësoni disi marrëdhënien tuaj duke mbajtur më shumë parasysh shqetësimet, mendimet apo dëshirat e partnerit.



Ujori (21 janar - 19 shkurt)

Përpara se të veproni analizoni faktet e fundit që mund të kenë ndryshuar tërësisht ose pjesërisht projektet tuaja. Në dashuri, mundohuni të lini mënjatë polemikat dhe të veproni me kujdes e optimizëm. Në profesion do të përballemi me sukses problemet e lidhura me evolucionin teknologjik.



Peshqit (20 shkurt - 20 mars)

Do të keni aleatë të rëndësishëm mes yjeve, si Jupiterin dhe Marsin, që mund t'ju ndihmojnë për t'ia dalë mbanë edhe në detyrat që deri më tash ju janë dukur të pamundshme. Nëse doni të përqëndroni vëmendjen në sferën private, jini sa më të natyreshëm dhe optimistë, do të keni sukses.



Stop Gjymtimit të Gjenitaleve femërore!

Në Itali janë rreth 90 mijë gra emigrante që kanë pësuar dhunën e gjymtimit të organeve gjenitale. Viktimat janë kryesisht vajza të vogla nga 4 deri në

15 vjeç. Mes dëmeve të shkaktuara: sëmundje, marrëdhënie seksuale të dhimbshme, shterpësi dhe lindje të rrezikshme. Stop MGF është fushata e sensibilizimit e promovuar nga NoDi dhe departamenti i Mundësive të barabarta.

Të premten 2 tetor, ora 17.00 në Shtëpinë Ndërkombëtare të Grave në Via della Lungara 19, Romë, evenimenti përmbyllës i dy vjetëve punë. Vizitoni edhe ueb-sitin tonë: www.stop-mgf.org



Shtëpi fshati në shitje

Montese (pr. Modena)
 Kompleks banimi krejtësisht i pavarur aktualisht i përdorur si bed&breakfast dhe banesë për pronarin. Sipërfaqja e përgjithshme 618,00 m² të ndarë në dy apartamente, tavërnë-studio me shërbime, magazina dhe ish-shtojcë bujqësore tashmë e përdorur si oborr i brendshëm. Oborri dhe ndërtesa shtrihen për 1280,00 m². E ristrukturuar, lehtësisht e arritshme; rrugë hyrjeje private; vendndodhje panoramike. Kërkohe 965euro/m², çmim i diskutueshëm. E shkëlqyer për banesë, veprimtari kreative apo për aktivitet zejtarie të vogël.

Mund ta shihni në:
<http://www.immobiliare.it/9167585-rustici-in-vendita-Montese.html>
 Kontakte: Malcolm Leanza
 cell. 338 9720451 / tel: 0577 943152 / fax: 0577 906077

a mund të dërgoj para
në **shqipëri** me

7€* komision?



transferta nga 100€ për në shqipëri duke filluar nga 7€**

tani edhe nga **toskana**

shuma	komision*
€0,01 - €100	€7,00
€100,01 - €200	€10,00
€200,01 - €300	€13,50
€300,01 - €400	€17,00

shuma	komision*
€400,01 - €600	€26,00
€600,01 - €800	€34,00
€800,01 - €1.000	€44,50

oferta është e vlefshme nga 24 marsi 2009 në të gjitha agjencitë western union në lombardi, emilia romagna, piemonte, liguria, valle d'aosta, trentino alto adige, veneto, friuli venezia giulia dhe toskanë.

* fondet në përgjithësi janë të disponueshme në pak minuta në varësi të afateve dhe kushteve të shërbimit, duke përfshirë dhe oraret e agjencive si dhe ndryshimet në orën lokale, për më tepër shikoni formularin e dërgesës për kufizimet. **përveç komisionit, western union përfiton para shtesë kur këmben paratë tuaja në monedhen vendase. Komisionet standarte fillojnë me 1000.01 euro të dërguara në një transakcion. Për listën standarte të komisioneve ju lutemi, vizitoni agjencitë tona.

WESTERN UNION | *yes!*

familja juaj mund t'ju ndiejë pranë me një transfertë parash, kudo që ju mund të ndodheni.

+355 42 23 49 79

transfertë parash

gettare negli appositi cestini per proteggere l'ambiente.

© 2009 WESTERN UNION HOLDINGS, INC. All rights reserved.